

1 E martë, 22 shkurt 2022

2 [Seancë]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit marrin pjesë përmes videolidhjes]

5 [I akuzuari Veseli nuk është i pranishëm]

6 --- Seanca fillon në orën 14.30

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita. Mirë se erdhët të
8 gjithë brenda dhe jashtë sallës.

9 Zonja Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

10 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar
11 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-06, Prokurori i
12 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
13 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja
15 Sekretare.

16 U lutem palëve dhe pjesëmarrësve të prezantohen, duke
17 filluar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar.

18 Zoti Prokuror, keni fjalën.

19 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar
20 Gjykatës. Sot Zyra e Prokurorit të Specializuar përfaqësohet
21 nga zoti Alan Tieger, Prokuror i Lartë; Nathan Quick,
22 Bashkdrejtues; Nada Kiswanson, Nëpunëse Juridike; dhe unë Ward
23 Ferdinandusse, Shef i Hetimeve të Prokurorisë.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

25 Zoti Kehoe, keni fjalën.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës. Unë
2 jam Gregory Kehoe, bashkë me mua është Peter McCloskey, Sophi
3 Menegon, Bonnie Johnston dhe, në pjesën e pasme kemi dhe
4 pjesën tjetër të ekipit që përfaqësojnë zotin Thaçi.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

6 Zoti Emmerson, keni fjalën.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mirëdita. Është zonja O'Reilly,
8 Bashkëmbrojtëse; zoti Samir Sali, ndihmës juridik; Anouk
9 Julien, Menaxher i Lëndës; dhe, për herë të parë paraqitet, të
10 nderuar Gjykatës, Tomas Moreno Ocampo, një prej stazhierëve
11 tanë; gjithashtu është dhe Bashkëmbrojtësi Andrew Strong, i
12 cili mund të jetë në gjendje që të flasë më me hollësi për të
13 gjitha pikat.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

15 Zoti Roberts, ju lutem.

16 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jam Geoffry Roberts në emër të
17 zotit Selimi paraqitem këtu në sallë, së bashku me mua është
18 dhe zoti Eric, zonja Natalia Ryzhenko, Menaxhere e Lëndës; dhe
19 anëtarët e tjerë të ekipit.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

21 Vura re.

22 Zonja Alagenda, ju lutem.

23 Ah, më falni. Po, zoti Baiesu.

24 z. BAIESU: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës.

25 Mirëdita, të gjithëve. Jam Victor Baiesu, paraqitem në emër të

1 zotit Jakup Krasniqi. Me videolidhje kemi Kryembrojtësen
2 zonjën Venkateswri Alagendra; Bashkmbrojtësin, zotin Aidan
3 Ellis; dhe, zotin Mentor Beqirin, asistent juridik. Dhe unë
4 këtu asistohem sot në sallë nga zonja Kalina Tzvetkova,
5 Menaxhere e Lëndës; dhe zonja Laura Abia, mbështetëse e
6 ekipit.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, nuk përmenda tre
8 kolegë që i kemi me videolidhje, zotin Luca Mishetiç, zotin
9 Dastid Pallaska dhe zotin Janathan Greenblatt. Ju kërkoj
10 ndjesë.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

12 I kthehem tani Mbrojtësit të Viktimave, zoti Laws.

13 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës.
14 Mirëdita të gjithëve. Jam Simon Laws, jam Mbrojtës i Viktimave
15 në këtë çështje gjyqësore.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Laws.

17 Tani i kthehem Zyrës Administrative. Zoti Nilsson, keni
18 fjalën.

19 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës.
20 Mirëdita dhe kolegëve. Jam Jonas Nilsson përfaqësoj Zyrën
21 Administrative sot.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

23 Për procesverbalin vërej se zoti Thaçi, zoti Selimi dhe
24 zoti Krasniqi kanë hequr dorë nga e drejta për të marrë pjesë
25 personalisht, por ndjekin përmes videokonferencës. Vërej se

1 zoti Veseli ka hequr dorë që ta përcjellë këtë seancë.

2 Jam Nicolas Guillou, Gjykatës i Procedurës Paraprake për
3 këtë çështje gjyqësore.

4 Më datë 16 shkurt të vitit 2022, me kërkesë të Mbrojtjes
5 së Thaçit, kam caktuar datën për këtë seancë për të dëgjuar
6 parashtrimet për çështjet e ngritura nga propozimi i ZPS-së
7 për një protokoll mbi trajtimin e informacioneve konfidenciale
8 dhe kontaktet me dëshmitarët e palës kundërshtare gjatë
9 hetimeve.

10 Qëllimi i seancës sot është që t'ju jepet mundësia palëve
11 dhe pjesëmarrësve që të diskutojnë për propozimin fillestar
12 dhe të ndryshuar të ZPS-së.

13 I ftoj palët që të mos përsërisin parashtrimet e bëra
14 paraprakisht por të përqendrohen në pyetjet konkrete të cilat
15 i kanë përfshirë në urdhrin për caktimin e datës së seancës
16 duke i marrë për aq sa këto, pra, pyetje kanë të bëjnë me
17 secilën palë dhe pjesëmarrës veçmas.

18 Në veçanti, u kërkoj palëve që të fokusohen tek këto
19 pyetje: cila do të ishte baza ligjore për propozimin e ZPS-së;
20 një protokoll i tillë a do t'i shkelte të drejtat e të
21 akuzuarëve, duke vënë re gjithashtu se protokolle të ngjashme
22 janë miratuar dhe ndjekur nga Gjykata të tjera ndërkombëtare;
23 nëse propozimi, protokollin e propozuar do të shqyrtohej, ky do
24 të zbatohet për të gjithë dëshmitarët apo vetëm për një
25 kategori të veçantë dëshmitarësh; dhe një model i zhvilluar

1 nga ICC-ja lidhur me këtë çështje apo dhe model tjetër e
2 veçantë i zhvilluar nga organizata, gjykata të tjera
3 ndërkombëtare do të mund të zbatoheshin apo jo nga Dhomat e
4 Specializuara.

5 Së fundi, i ftoj palët që të bëjnë të ditur nëse
6 diskutimet *inter partes* do të ishin të dobishme për të arritur
7 një marrëveshje lidhur me protokoll e propozuar; dhe për cila
8 pika në veçanti.

9 Siç e kam bërë të qartë në urdhrin për caktimin e datës
10 së seancës, secila palë dhe pjesëmarrës do të ketë në
11 dispozicion 15 minuta për të bërë parashtrime, përjashtuar
12 këtu kohën që është e nevojshme për t'u përgjigjur secilës
13 prej pyetjeve që kam parashtruar.

14 Përpara se sa t'ia jap fjalën palëve, vërej se Mbrojtja e
15 zotit Thaçi kërkon që përgjigja e Mbrojtësve të Viktimave ndaj
16 parashtrimeve të Zyrës Administrative të hiqet nga
17 dokumentacioni i Gjykatës, pra, nga procesverbali. Do t'i jap
18 mundësinë, rrjedhimisht, Mbrojtësit të Viktimave që të bëjë
19 parashtrime lidhur me këtë kërkesë veçmas nga çështjet që janë
20 paracaktuar në rendin e ditës. Dhe, po kështu edhe Mbrojtja e
21 zotit Thaçi mund të trajtojë ndonjë prej çështjeve të ngritura
22 nga Mbrojtësi i Viktimave pa përsëritur asnjë parashtrim të
23 bërë në kërkesë.

24 Në fillim, zoti Laws, dëshironi të bëni ndonjë parashtrim
25 lidhur me këtë?

1 Pra, jo për themelin e diskutimeve sot. Faleminderit.

2 Vetëm për kërkesën e zoti Thaçi. Faleminderit.

3 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

4 Ne nuk e pranojmë aspak atë që është thënë në
5 parashtrimin e protokolluar të zotit Thaçi. Do ta kem për
6 kënaqësi që ta trajtoj në secilën mënyrë sesi e shikon të
7 konsiderueshme i nderuar Gjykatës, qoftë duke protokolluar një
8 përgjigje apo në parashtrime të tjera.

9 Nuk do të ishte një përdorim produktiv i kohës sot që të
10 harxhonim shumë prej kohës tuaj sepse do të shohim në fund të
11 seancës sot që kjo kërkesë do të dalë e panevojshme, pra, për
12 të marrë përgjigjen. Është mbi këtë bazë që ne, si të thuash,
13 e kundërshtojmë këtë parashtrim. Dhe ky do të ishte
14 parashtrimi im për të mos e zgjatur më tej.

15 Megjithatë, unë do të doja që t'ju jepja një --

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirë të vazhdojmë kështu.

17 Na jepni vetëm pikat kryesore siç propozoni ju, pra, të
18 merremi me këtë dhe jo tërësinë e parashtrimeve tuaja.

19 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit.

20 Aty kemi dy pika. Së pari është një kundërpërgjigje,
21 dokumenti, pra, që ne e kemi protokolluar. Prandaj dhe ky
22 dokument e kapërcen numrin e lejuar të fjalëve. Ajo që do të
23 thoshim për këtë është që nuk i takon Mbrojtjes së Thaçit që
24 të caktojë etiketime të këtilla që ato dëshirojnë ndaj një
25 parashtrimi të protokolluar. Është në vendimin e të nderuarit

1 Gjykatës që duhen të protokolluar përgjigjet. Kjo nuk ka të
2 bëjë me kundërpërgjigjet.

3 Prandaj dhe përgjigja ishte brenda afatit kohor. Ishte
4 brenda numrit të lejuar të fjalëve.

5 Argumenti i dytë i tyre është se kemi dalë jashtë
6 objektit të kërkesës për të dhënë parashtrime me shkrim. Por,
7 ata nuk trajtojnë qëllimin e këtij parashtrimi të protokolluar
8 që përcaktohet në paragrafin 1 dhe është ky: i nderuar
9 Gjykatës ka bërë të ditur se do të marrë një vendim nëse duhet
10 të ketë apo jo një seancë të mbajtur gojarisht.

11 Më datë 4 shkurt, i nderuar Gjykatës, bëri të ditur që
12 këtë vendim nuk e kishte marrë ende. Zakonisht, palëve u
13 lejohet që të bëjnë parashtrime në lidhje me vendime gjyqësore
14 të cilat ende nuk kanë dalë, pra, ende nuk janë marrë. Askush
15 nuk kishte tërhequr vëmendjen ndaj protokollit të vetë ICC-së,
16 pra, të Gjykatës Penale Ndërkombëtare.

17 Pa përsëritur atë që unë kam thënë në parashtrimin e
18 protokolluar, qëndrimi ynë është që ZPS-ja ka propozuar një
19 kornizë shumë të re, shumë ekstreme, sipas parashtrimit të
20 tyre, pra, të Mbrojtjes, në fakt, nuk është kështu. Është
21 mjaft i afërt me protokollin e ICC-së.

22 Megjithatë, më datë 4 shkurt, askush nuk e kishte sjellë
23 këtë në vëmendjen e të nderuarit Gjykatës. Ka një boshllëk të
24 pavolitshëm në materialin që parashtrohet përpara Gjykatësit.
25 Dhe, unë mendoj, se do të ishte e rrezikshme që të arrije në

1 një përfundim të tillë në bazë të kësaj.

2 Pra, në këto rrethana, ne mendonim se nuk na takonte ne
3 që ta asistonim të nderuarin Gjykatës me informacione të tjera
4 shtesë. Pra, jo vetëm që na takonte por edhe e kishim për
5 detyrim që ta bënim këtë gjë. Ne shohim që protokolli i
6 ngjashëm i ICC-së zë një vend të rëndësishëm në rendin e ditës
7 së kësaj seance sot, pa dashur që të thellohem më shumë në
8 parashtrimet e mia sepse e di që do të diskutohet më tej në
9 parashtrimet e palëve sot në këtë seancë.

10 Megjithatë mund t'i kthehem kësaj më pas nëse i nderuar
11 Gjykatës dëshiron.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

13 Zoti Kehoe, dëshironi që t'i përgjigjeni?

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

15 Unë mendoj se i ka keqkuptuar Mbrojtësi i Viktimave
16 parashtrimet tona.

17 I nderuar Gjykatës, i kërkojmë ekipeve të Mbrojtjes si
18 edhe ZPS-së që të jepnin komentet e tyre lidhur me
19 parashtrimet e Zyrës Administrative.

20 Mbrojtësi i Viktimave zgjodhi që të mos t'u përgjigjet
21 këtyre. Ai vendosi që të kritikonte parashtrimin tonë të
22 protokolluar të datës 15 dhjetor. Çdo parashtrim i tillë i
23 protokolluar që i përgjigjet kësaj, është tërësisht jashtë
24 afatit, me muaj jashtë afatit. Ato nuk i janë përgjigjur
25 parashtrimeve të Zyrës Administrative.

1 Prandaj dhe kritika jonë ishte se ata kishin dalë jashtë
2 objektit të parashtrimeve, siç i kërkonte i nderuari Gjykatës;
3 së dyti, ata nuk e bënë këtë në afatin e duhur; dhe, së treti,
4 e shfrytëzuan për të bërë kritika ndaj parashtrimit tonë të
5 dhjetorit 2021.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

7 Kalojmë tani në rendin e ditës.

8 Do t'ia jap fjalën Prokurorisë, pas së cilës ekipeve të
9 Mbrojtjes, pastaj përfaqësuesi i viktimave dhe pastaj Zyra
10 Administrative.

11 I kujtoj palët dhe pjesëmarrësit që të na informojnë
12 paraprakisht nëse parashtrimet e tyre kërkojnë nxjerrjen e
13 informacioneve konfidenciale në mënyrë që të merren masat e
14 duhura.

15 Zoti Prokuror, keni fjalën për 15 minuta, ju lutem.

16 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
17 Gjykatës.

18 ZPS-ja ka paraqitur një propozim për kornizën e trajtimit
19 të informacionit konfidencial në kuadër të dëshmitarëve të
20 palës kundërshtare. Dhe, siç e tha edhe Mbrojtësi i Viktimave
21 tani, nuk ka asgjë në këtë kornizë të propozuar që është e re
22 apo e jashtëzakonshme.

23 Korniza është përpiluar në bazë të kornizave të ngjashme
24 të cilat janë zbatuar në një çështje tjetër gjyqësore në këtë
25 Gjykatë por edhe në Gjykata të tjera ndërkombëtare përfshirë

1 këtua dhe Gjykatën Penale Ndërkombëtare. Çdo dispozitë e kësaj
2 kornize të propozuar është zbatuar ose përpara kësaj Gjykate
3 ose përpara Gjykatës Penale Ndërkombëtare ose përpara
4 gjykatave të tjera.

5 Prandaj, kjo është e rëndësishme të thuhet dhe ka rëndësi
6 për shumë prej pyetjeve për të cilat po diskutojmë sot. Ne nuk
7 po diskutojmë këtu për ide të reja, por gjëra janë zbatuar më
8 përpara. Njëkohësisht vështirësitë me të cilat përballet kjo
9 Gjykatë përfshirë këtu mbrojtjen e mirëqenies dhe sigurisë së
10 dëshmitarëve, përfshirë dhe integritetin e dëshmisë dhe
11 provave, janë unike për këtë Gjykatë.

12 Kjo Gjykatë ekziston për t'u sjellë drejtësi viktimave në
13 kuadër të një atmosfere afatgjatë frikësimi që shumë shpesh e
14 ka penguar drejtësinë gjatë më shumë se 20 viteve. Gjithnjë e
15 më shumë, ka shumë punonjës të cilët në mënyrë korrekte, e në
16 të gjitha organet e kësaj Gjykate, po punojnë për këtë
17 objektiv. Për t'u sjellë drejtësi viktimave. E shkuara ka
18 treguar se proceset gjyqësore kundër personave të pandehur që
19 akuzohen për krime të kryera ndërkohë që kanë qenë anëtarë të
20 UÇK-së edhe qoftë kur nuk kanë qenë nga nivelet e larta
21 drejtuese, janë karakterizuar nga një nivel i jashtëzakonshëm
22 stresi dhe frike nga ana e dëshmitarëve dhe se shumë prej
23 këtyre dëshmitarëve ose kanë refuzuar që të dëshmojnë ose i
24 kanë ndryshuar dëshminë e tyre kur kanë dalë në sallën e
25 gjyqit.

1 Prandaj dhe ne e kemi parashtruar që më parë, se kjo nuk
2 është diçka sporadike apo një gjë që ndodh rrallë. Do të
3 ndodhë, sigurisht, që të ketë dëshmitarë që të tërhiqen apo të
4 kenë frikë të dëshmojë apo të ndryshojnë dëshminë e tyre për
5 shkak të frikës apo të besnikërisë që mund të kenë ndaj të
6 pandehurve. Do të ketë edhe shumë dëshmitarë të tillë në këtë
7 çështje gjyqësore.

8 Korniza e propozuar është e domosdoshme për të mundësuar
9 shumë prej dëshmitarëve që të japin e dëshminë e tyre e
10 pafrikë edhe t'i japë mundësi Gjykatës që të konstatojë se ku
11 qëndron e vërteta kur dëshmitarët, për shembull, nuk i
12 qëndrojnë besnik versioneve të tyre të mëparshme. Duke pasur
13 një dokumentacion për kontaktet paragjyqësore dhe duke i dhënë
14 mundësi të dyja palëve që të bëjnë parashtrime kjo do ta
15 rriste mundësinë e konstatimit të së vërtetës.

16 Prandaj, për t'u përgjigjur pyetjes së parë, i nderuar
17 Gjykatës, korniza e propozuar mund të urdhërohet në bazë të
18 këtyre dispozitave ligjore: Neni 23 dhe rregulli 80 për
19 mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve; Neni 39(1), (3), 11
20 dhe 13; dhe rregulli 82 dhe 83 për mbrojtjen e informacionit
21 konfidencial. Dhe, sigurisht, zbatimi i rregullit 80 nuk është
22 se është objekt i një afati kohor në këtë rast, sepse afati i
23 vendosur aty ka të bëjë vetëm me nxjerrjen.

24 Pyetja e dytë, i nderuar Gjykatës, pra, nëse kjo kornizë
25 e propozuar do të zbatohet për të gjithë dëshmitarët apo vetëm

1 për një kategori dëshmitarësh. Korniza e propozuar mbulon jo
2 vetëm dëshmitarët e ZPS-së por duhet formuluar në atë mënyrë
3 që të mbulojë njëkohësisht të gjitha palët. Ajo duhet të
4 zbatohet për të gjithë dëshmitarët, për të mbrojtur
5 integritetin e dëshmive dhe për të shërbyer si një garanci
6 kundër dyshimeve apo pretendimeve për ndërhyrje te dëshmitarët
7 të cilat do të mund t'ia ulnin vlerën e rezultatit të kësaj
8 çështje gjyqësore.

9 Duhet theksuar se ajo nuk ka me doemos lidhje me masat
10 mbrojtëse dhe presionin e ushtruar mbi dëshmitarët. Disa
11 dëshmitarë pa masa mbrojtëse janë po kështu njësoj objekt i
12 trysnisë.

13 Pyetja e tretë, i nderuar Gjykatës, sa i takon argumentit
14 për gjykim të drejtë. Reagimi ynë, i ZPS-së, mund të jetë po
15 aq i shkurtër sa mund të jenë argumentet, pra, sigurisht që
16 këto janë të gjata. Mbrojtja ka bërë disa parashtrime.

17 Argumentet e propozuara nga Mbrojtja janë ngritur në
18 mënyrë të përsëritur dhe janë rrëzuar nga ICC-ja kur janë
19 propozuar dhe pastaj miratuar protokolle të ngjashme.

20 Pra, Mbrojtja e produktit të punës së brendshme apo
21 privilegjet klient-avokat apo e drejta kundër vetë fajësimit
22 nuk zbatohet në rastin kur Mbrojtja nxjerr informacion në
23 mënyrë vullnetare një pale të tretë, përfshirë këtu
24 dëshmitarin apo dëshmitarët e mundshëm.

25 Me intervistimin e një dëshmitari në praninë e një pale

1 tjetër nuk do të thotë që t'i tregosh palës tjetër strategjinë
2 që ke. Kjo do të thotë, në fakt, se ke bërë vendimin e zgjuar
3 përdoret në mbarë botën.

4 E drejta për të t'i bërë pyetje dëshmitarëve nuk
5 përfshin të drejtën për ta intervistuar dëshmitarin e palës
6 kundërshtare pa mbikëqyrje apo një farë kontrolli. Të
7 pandehurit kanë të drejtën që t'i bëjnë pyetje dëshmitarëve me
8 rëndësi kur të jenë ata anë sallën e gjyqit dhe jo dy herë,
9 përfshirë këtu edhe në rastin e gjykimeve *ex parte*.

10 Përgatitjet efektive për bërjen e pyetjeve në sallën e
11 gjyqit mund të marrin shumë forma të ndryshme lidhur me
12 kontaktin me dëshmitarët.

13 Për shembull, në rastin Haliloviç në TPNJ, Dhoma e
14 Procedurës Paraprake refuzoi që t'i jepte mundësi Mbrojtjes që
15 të thërriste dëshmitarët e Prokurorisë sepse Mbrojtjes do t'i
16 jepej mundësi që t'u bënte pyetje atyre në gjykim.

17 Në një çështje tjetër gjyqësore -- në çështje të tjera
18 gjyqësore në Tribunalin për Ruandën, Tribunali në fjalë, mori
19 vendimin se intervistat në procedurë paraprake mund të
20 zhvilloheshin vetëm në praninë e palës thirrëse të dëshmitarit
21 për të pakësuar sa më shumë kështu pretendimet për ndërhyrje
22 në dëshmitarë.

23 Një gjë e ngjashme është vendosur eshë në një çështje
24 tjetër në një tribunal tjetër.

25 Të gjitha këto vendime të këtyre gjykatave janë marrë,

1 pra, në konsideratë edhe të drejtat e Mbrojtjes. E njëjta vlen
2 edhe për shumë sisteme të tjera ligjore ku nuk zhvillohen fare
3 intervistat e mëtutjeshme me dëshmitarët. Këto intervista mund
4 të zhvillohen vetëm me urdhër të Gjykatës, përndryshe
5 dëshmitarëve mund t'ju bëhet pyetje në sallë e gjyqit.

6 Gjykatësit në këtë Gjykatë, të cilët kanë hartuar edhe
7 kenë zbatuar më përpara një protokoll të ngjashëm, pra,
8 gjykatësit në këto gjykata e kisha fjalën, i kanë mbajtur
9 parasysh e dhe të drejtat e të akuzuarve. Sigurisht në rastin
10 tonë rrjedhoja logjistike janë të ndryshme për shkak të numrit
11 të dëshmitarëve, megjithatë të drejtat janë në drejtpeshim.

12 Pyetja e katërt, sa i takon intervistave të përbashkëta,
13 ZPS-ja parashton se ekipet e Mbrojtjes nxiten që të
14 zhvillojnë intervista të përbashkëta. Madje, në rastin e
15 dëshmitarëve që kanë edhe statusin e viktimës, duhet të jenë
16 të detyruar që ta bëjnë këtë gjë. Për të gjithë dëshmitarët,
17 sidomos për viktimat, intervistat në një numër të madh të
18 rasteve janë ritramatizuese.

19 Pyetja e pestë dhe e gjashtë nuk janë trajtuar nga ZPS-
20 ja.

21 Pyetja e shtatë ka të bëjë me modelin e ICC-së apo një
22 model nga gjykatat e tjera. Protokolli i propozuar është i
23 ngjashëm, madje identik në shumë aspekte, me protokollet të
24 ndjekura nga Gjykata Penale Ndërkombëtare. Në bazë të
25 rrethanave të veçanta me të cilat has kjo Gjykatë dhe sidomos

1 kjo çështje gjyqësore në veçanti, pjesëmarrja në mënyrë të
2 përsëritur në çështjet gjyqësore që kanë të bëjnë me anëtarë
3 të UÇK-së, atmosfera e frikësimit, si edhe presioni unik me të
4 cilin do të përballen dëshmitarët kur të kontaktohen nga
5 ekipet e Mbrojtjes në këtë çështje gjyqësore, bëjnë të
6 domosdoshme disa ndryshime për të siguruar integritetin e
7 Mbrojtjes. Ne, si ZPS, mbajmë qëndrimin se protokollin i
8 propozuar është i domosdoshëm dhe i përshtatur me rrezikun
9 objektivisht të arsyetuar.

10 Gjykata ka autorizuar tashmë bërjen e redaktimeve
11 standarde për informacionin e kontaktit të dëshmitarëve edhe
12 informacionet identifikuese të individëve në rrezik. Sigurisht
13 disa prej këtyre do të kontaktohen nga ish-eprorët, siç është
14 për shembull ish-ministri i drejtësisë që i është bashkuar me
15 sa duket ekipit të Mbrojtjes së zotit Veseli.

16 Pa një protokoll solid për kontaktimin, do të cenohej
17 edhe qëllimi i redaktimeve të cilat janë miratuar.

18 Pyetja e tetë dhe fundit. ZPS-ja mendon se korniza duhet
19 të miratohet tani dhe se palët duhet që të veprojnë brenda
20 kësaj kornize.

21 Prandaj, ne ju kërkojmë që të urdhëroni që të zbatohet
22 korniza siç e kemi propozuar ne, të urdhëroni ekipet e
23 Mbrojtjes t'i raportojnë Prokurorisë që me cilët dëshmitarë
24 kanë kontaktuar, cilët kanë intervistuar përpara se të merrej
25 vendimi për zbatimin e kësaj kornize dhe të nxjerrin çdo

1 dokumentacion apo dokumentim apo incizim të këtyre kontakteve
2 dhe intervistave.

3 Nëse nuk bëhej kjo si alternativë nëse ju vendosni që të
4 bëni diskutime *inter partes*, ne ju kërkojmë që të urdhëroni që
5 kontaktet me dëshmitarët e palës kundërshtare të mos
6 zhvillohen derisa të merret një vendim.

7 Kam ardhur kështu në pikën e fundit. Disa ekipe të
8 Mbrojtjes, përfshi edhe atë të zotit Thaçi, janë mbështetur
9 tek Kodi i Sjelljes për të argumentuar se protokolli i
10 propozuar është i panevojshëm. Ky argument nuk qëndron. Nuk
11 mund të bëjmë një sy qorr ndaj realitetit që shohim në këtë
12 sallë sa herë që mblidhemi. Kodi i Sjelljes i Dhomave të
13 Specializuara të Kosovës kërkon që avokatët të mos bëjnë
14 deklarata të rreme apo njollosëse dhe të veprojnë me dinjitet
15 edhe integritet duke respektuar të gjithë ata të cilët marrin
16 pjesë në proces.

17 Procesverbali tregon qartë që ekipet e Mbrojtjes së zotit
18 Thaçi dhe zotit Veseli nuk i kanë zbatuar të gjitha këto
19 standarde dhe këtë e kanë bërë në mënyrë të vazhduar. Në
20 paragrafin 14 të parashtrimit të protokolluar të zotit Thaçi,
21 kryembrojtësi i zotit Thaçi parashtron se ekipi i tij nuk
22 është në dijeni të ankesave nga dëshmitarë të ZPS-së gjatë
23 intervistave gjatë 15 muajve të fundit.

24 15 muaj na çon deri në dhjetor të vitit 2020. Le të
25 mendojmë njëherë se çfarë është thënë në konferencat mbi

1 ecurinë e çështjes të vitit që shkoi.

2 Më 16 shkurt 2021, mbrojtësi i Thaçit i ka thënë kësaj
3 gjykate:

4 "Nuk kemi filluar hetimet. Ndërkohë unë nuk mendoj që
5 hetimet do të fillojnë përpara muajit prill".

6 Më 24 mars 2021, zoti Prosper na ka thënë në këtë sallë
7 se ekipi i zotit Thaçi nuk ishte në gjendje të fillonte me
8 hetimet e Mbrojtjes në prill dhe me shumë shtjellime shpjegoi
9 pse ishte kështu.

10 Në 19 maj 2021, zoti Prosper informoi Gjykatën se ekipi i
11 Mbrojtjes së Thaçit nuk ishte në gjendje që të ofronte më
12 shumë qartësi mbi statusin e hetimeve të Mbrojtjes për të
13 ardhmen e parashikueshme derisa të merrnin më shumë
14 informacion nga Prokuroria.

15 Më 14 shtator 2021, zoti Kehoe ju tha juve, i nderuar
16 Gjykatës, dhe po citoj këtu:

17 "Nuk mund t'i jap i nderuar Gjykatës asnjë vlerësim sesa
18 kohë do të zgjasë hetimi".

19 Pra, diçka më shumë se para pesë muajsh. Pra, cila është?
20 Nuk mund të jenë të dyja këto të vërteta.

21 Më 15 muaj nga dhjetori 2020 e deri tani e përfshijnë
22 edhe muajin shkurt edhe mars edhe maj edhe shtator 2021. Dhe
23 pas kësaj qëndron një pyetje me shumë rëndësi: A duhet të
24 besojmë singërisht se avokat të tillë në mënyrë skrupuloze e
25 respektojnë kodin e kontakteve të paregjistruara me

1 dëshmitarë?

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju lutem mund ta mbyllni
3 zoti Prokuror, sepse thujse i keni mbaruar 15 minutat.

4 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Duhet të theksohet se
5 kërkesat tona janë shumë të kufizuara dhe të dhëna
6 shkurtimisht. I vetmi standard profesional dhe kërkesë që i
7 kërkohet Mbrojtjes, sa i takon kontakteve me dëshmitarët për
8 Prokurorinë, është ajo çfarë u parashtrua më sipër. Ndërkohë
9 që për pjesën tjetër Mbrojtja mund të vazhdojë me planet e
10 saja.

11 Ka mijëra dëshmitarë potencialë të cilët mund të jenë
12 objekt i marrjes së në pyetje nga Mbrojtja. Ajo çfarë po
13 kërkohet këtu është që të hidhet pak dritë mbi dëshmitarët
14 tanë dhe po kërkohet gjithashtu edhe zbatimin e të njëjtave
15 standarde edhe nga ne në momentin kur të dimë se cilët do të
16 jenë dëshmitarët e Mbrojtjes.

17 Në çështjen kundër Haradinajt, Gjykata në TPNJ jo vetëm
18 që ju referua situatës së rëndë për frikësimin e dëshmitarëve,
19 por gjithashtu theksoi se për një Gjykatë Ndërkombëtare, në
20 mënyrë që ajo të funksionojë siç duhet, organet gjyqësore
21 duhet që të marrin parasysh frikësimin e dëshmitarëve duke
22 marrë të gjitha masat të cilat duhet të merren në mënyrë të
23 arsyeshme me kërkesë të palëve, por gjithashtu edhe *proprio*
24 *motu*.

25 Shumë gjyqtarë në TPNJ dhe tribunale të tjera kanë

1 propozuar që një qëndrim i tillë të mund -- masat që ato kanë
2 marrë kanë qenë propozuese që edhe Trupi Gjykses të marrë të
3 njëjtën vendim këtu. Neve ju bëjmë thirrje që ta merrni këtë
4 vendim tani përpara sesa të bëhet tepër vonë.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti
6 Prokuror.

7 Kam dy pyetje që kanë të bëjnë me dallimin midis
8 propozimit tuaj dhe protokollit të GJPN-së.

9 Pyetja e parë është kjo: lidhur me praninë e
10 përfaqësuesve të palës thirrëse, në veçanti në një çështje ku
11 kjo është në kundërshtim me dëshirën, me vullnetin e shprehur
12 të dëshmitarit. Propozimi juaj këtu ndryshon nga protokollit
13 standard i GJPN-së. Cili është justifikimi juaj lidhur me
14 këtë?

15 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ne kemi
16 parë protokolle të ndryshme dhe kemi vënë re se GJPN-ja ka
17 zbatuar modele të ndryshme. Kur shohim protokolle të ndryshme,
18 në fakt, nuk është se kemi një rast të vetëm ose një model që
19 përdor vetëm propozimin që është hedhur këtu për shqyrtim dhe
20 nga ana tjetër propozimi që ne kemi dhënë nuk është në shkelje
21 të së drejtës për gjykim të drejtë.

22 Siç e thamë, neve besojmë në faktin që propozimi që është
23 në shqyrtim është më i miri, duke pasur parasysh presionin e
24 jashtëzakonshëm që do të kenë dëshmitarët. Vërejmë gjithashtu
25 që ka edhe protokolle të tjera të cilat përfshijnë faktorë të

1 tjerë që mund të merren parasysh, përfshirë këtu edhe mënyrën
2 sesi kontaktohet dëshmitari, mënyrën sesi regjistrohet
3 intervista dhe mënyra sesi protokolli merret me praninë e
4 palës thirrëse. Pra, ka modele ku prania shikohet si e drejtë.
5 Ka modele të cilët kërkojnë pëlqimin e dëshmitarit për
6 intervistën. Dhe gjithashtu ekziston dhe mundësia që të bëhet
7 një përjashtim nga Trupi Gjykses. Dhe besoj që duke pasur
8 parasysh presionin e jashtëzakonshëm që ekziston, modeli që
9 kemi propozuar është modeli që duhet të miratohet nga kjo
10 Gjykatë edhe duhet të përdoret në këtë çështje.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] A mendoni që ky duhet të
12 jetë një vendim i ZPS-së apo i Trupit Gjykses?

13 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] E keni fjalën për praninë e
14 palës thirrëse?

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Kur dëshmitari as e kërkon
16 dhe as nuk jep pëlqimin.

17 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Si në rastet e tjera, si në
18 rastin e tribunaleve të tjera, në fakt, kjo është një e drejtë
19 që lind vetvetiu.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull.

21 Pyetja e fundit ka të bëjë me dallimin ndërmjet
22 informacionit konfidencial dhe dokumenteve konfidenciale.
23 Sepse, siç e keni vënë re, besoj, nga parashtrime të ndryshme,
24 Mbrojtja parashikon që duhet të bëhet një dallim ndërmjet të
25 dyjave.

1 Protokollet e GJPN-së parashikojnë që informacionet
2 konfidenciale nuk duhet të përfshijnë informacion të cilat
3 janë bërë publike në mënyrë legjitime edhe në qoftë se
4 informacione të tilla përfshihen në dokumente konfidenciale.
5 Pra edhe këtu kemi një mospërputhje të propozimeve që keni
6 bërë juve dhe modelit që është përdorur nga GJPN-ja.

7 Ju lutem, a na e shpjegoni dot sepse keni propozuar këtë
8 model të ndryshëm në këtë rast?

9 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni kjo
10 është një përgjigje që do më duhet pak kohë për t'i hedhur një
11 sy dhe në qoftë se më lejoni do t'i jap një përgjigje pak më
12 vonë.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit,
14 zoti Prokuror.

15 Tani le të kalojmë te Mbrojtësi i Avokatit [sipas
16 përkthimit]. Zoti Laws, fjala për juve. Keni 15 minuta në
17 dispozicion.

18 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit. Atëherë sa i takon
19 pyetjes 1, kjo është një çështje që i tako ZPS-së dhe nuk kemi
20 parashtrime lidhur me të.

21 Lidhur me pyetjen 2, përgjigja që ne japim në qoftë se
22 protokolli duhet të zbatohen për të gjithë dëshmitarët,
23 përgjigja jonë është "po".

24 Ne përfaqësojmë padiskutim edhe dëshmitarët me status të
25 dyfishtë, por si propozim i përgjithshëm përgjigja është që

1 protokolli duhet që të zbatohet ashtu siç zbatohet edhe
2 gjetkë. Protokolli i kësaj natyre promovon transparencë në
3 proceset gjyqësore. Promovon sigurinë lidhur me atë çfarë
4 thuhet nga dëshmitarët dhe gjithashtu edhe shmang keqkuptimet
5 apo pretendimet të cilat mund të bëhen në një drejtim ose në
6 një drejtim tjetër dhe siç tha edhe kolegu i ZPS-së, zbatohen
7 në të njëjtën mënyrë për të dyja anët. Kështu që përgjigja për
8 pyetjen e dytë është: Po, protokollet duhet që të zbatohen për
9 të gjithë dëshmitarët.

10 Sa i takon organizimeve specifike në qoftë se ato
11 kërkohen apo jo për dëshmitarët e dyfishtë, përgjigja jonë
12 është po, duhen të bëhen organizime specifike që kërkohen në
13 rastin e kësaj kategorie dëshmitarësh. Dhe dua që të cek dy
14 organizime të tilla, nëse do më lejoni.

15 Njoftimi nga ana tjetër ose le të themi, për sa i takon
16 Mbrojtjes së Viktimave. Thaçi në parashtrimet e veta thotë që
17 ne nuk duhet të kemi një dispozitë të caktuar që ka të bëjë me
18 përcaktimin e dëshmitarëve me status të dyfishtë sepse kjo gjë
19 ndalohet pa dhënë informimin e Mbrojtjes së dëshmitarit. Dhe
20 më lejoni të them, që kjo është e saktë. Megjithatë, do të
21 doja që të shtoja që në qoftë se ekziston diçka çfarë
22 kundërshtimi ka që kjo të mund të përfshihet në kornizë? Pra,
23 ky nuk është një detyrim shtesë, por është një detyrim i cili
24 do të duhet të respektohet prej tyre.

25 Së dyti, në qoftë se ne mbledhim së bashku të gjitha

1 mënyrat e ndryshme, mendoj që të gjitha sjelljet tona do të
2 duhet të rregullohen, në vend që të themi që ta heqim këtë
3 dispozitë sepse mund ta gjeni atë diku tjetër dhe me thënë të
4 drejtën kjo në vetvete duket sikur cenon vetë qëllimin e
5 pasjes së një kuadri. Sepse ideja është që korniza, vendimi
6 kornizë, pra, të jep kornizën e përgjithshme dhe duhet të
7 gjesh përgjigjet aty dhe të mos shkosh dhe të shikosh diku
8 tjetër kur të kesh kohë.

9 Kështu që në kuptimin tonë është shumë herë më e thjeshtë
10 edhe më e kuptimtë që korniza të ketë një fushë veprimi
11 gjithëpërfshirëse dhe jo vetëm që të zgjidhësh çfarë të duash.

12 Po ashtu, më lejoni të them, që edhe GJPN-ja ka një
13 parashikim të ngjashëm sa i takon trajtimin të kontaktit me
14 klientët dhe duket sikur as GJPN-ja në vetvete nuk është se e
15 ka lënë nevojën ose e ka përjashtuar nevojën për dhënien e
16 njoftimit. Sa i takon ndryshimit të parë lidhur me gjendjen
17 dhe statusin e dëshmitarëve, ne mendojmë që rregullimet ose
18 masat të cilat u prezantuan nga ZPS-ja do të duhet që të
19 miratohen.

20 Një tjetër konstatim kemi lidhur me paragrafin 17. Nuk
21 është se do ta them në detaje, megjithatë ajo ka të bëjë me
22 përgjigjen ndaj pyetjes së dytë. Më lejoni të citoj që: në
23 qoftë se kërkohet nga dëshmitari, Mbrojtja e Viktimave duhet
24 që të lejojë që të jetë e pranishme në intervistë.

25 Dhe duhet t'i referohem këtu çështjes al-Hasan, çështje e

1 cila është trajtuar nga TPNJ-ja kur është lejuar një gjë e
2 tillë, pra, që Mbrojtja e Viktimës të jetë e pranishme në
3 qoftë se kërkohet. Dhe kjo është një kërkesë shtesë që ka të
4 bëjë me statusin e dëshmitarëve të dyfishtë. Ky është fundi i
5 përgjigjes që kam lidhur me pyetjen 2.

6 Për pyetjen 3, mendoj që përveç asaj çfarë thashë më
7 përpara e kam dhënë edhe me shkrim në parashtrimet e mia
8 opinionin, vlerësimin, qëndrimin tim lidhur me të drejtat për
9 gjykim të drejtë të të akuzuarve në qoftë se ata cenohen apo
10 jo dhe, në qoftë se më lejoni, nuk dua që t'i përmend edhe një
11 herë ato, por i qëndroj parashtrimeve që kam bërë me shkrim.

12 Lidhur me pyetjen 4. A e miratojmë atë çfarë është
13 propozuar nga ZPS-ja. Pra, në qoftë se Mbrojtjet, pra, lejohen
14 që të bëjnë intervistim të përbashkët të dëshmitarëve,
15 përgjigja jonë është që ato duhet ta bëjnë një gjë të tillë në
16 qoftë se ata planifikojnë që të marrim në pyetje të njëjtët
17 dëshmitarë ose viktimë që mund të jetë edhe dëshmitarë apo
18 kategori të tjera të cenueshme të dëshmitarëve që do të merren
19 në pyetje prej tyre. Nuk ja vlen që të intervistohen, për
20 shembull, i njëjti person katër herë të ndryshme nga secili
21 prej ekipeve të Mbrojtjes së katër të akuzuarve. Vetëm në
22 rrethana përjashtimore mund të justifikohet një intervistë e
23 dytë me të njëjtin person edhe kjo duhet të ndodhë në qoftë se
24 ka një lloj kontrolli nga Trupi Gjykses.

25 Pyetja numër 5 ka të bëjë me Zyrën e Administrimit dhe

1 nuk dua të humbas më tepër kohë lidhur me të.

2 Kalojmë më tej me pyetjen 6. Pra, cili është pozicioni i
3 Mbrojtjeve dhe i avokatit të viktimave sa i takon protokollit
4 të përditësuar të ZPS-së. Pozicioni ynë është që: ne nuk e
5 kundërshtojmë ndryshimin që është bërë në parashtrimin e ZPS-
6 së sa i takon kornizës. Ne i kuptojmë vështirësitë praktike
7 për Zyrën e Administrimit sa i takon përmbushjes së detyrimeve
8 të tyre siç janë parashtruar fillimisht në kornizën e
9 propozuar nga ZPS-ja.

10 Sugjerojmë që protokolli, megjithatë, të jetë fleksibël
11 sa i takon pranisë së Zyrës së Administrimit në raste
12 përjashtimore. Ne ju inkurajojmë, i nderuar Gjykatës, që të
13 lini një element vendimmarrjeje diskrecioni ose ndoshta të
14 thuhet që vendimi duhet që të merret nga Trupi Gjykues kur ka
15 rrethana përjashtimore që mund të dalin nga njëra anë ose nga
16 tjetra.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ndjesë që ju ndërpres, por
18 kam një pyetje tjetër pasuese. Cilat do të ishin rrethanat e
19 tilla përjashtimore? Çfarë keni në mendje? Një ose dy shembuj
20 në qoftë se s'e keni problem.

21 Z. LAWS: [Përkthim] Është shumë e vështirë që të
22 parashikohet. Ne kemi bërë disa diskutime lidhur me ato
23 rrethana të cilat mund të ngrihen dhe që mund të jenë
24 përjashtimore. Dhe rrethana të tilla, për shembull, mund të
25 jenë dëshmitarë të cënueshëm intervista e të cilit nuk vijon

1 ashtu siç ishte planifikuar dhe kërkon kontroll plus nga Zyra
2 e Administrimit. Për shembull, është e pamundur që të
3 parashikohen të gjitha mënyrat që mund të bien nën këtë
4 propozim nën këtë pikë të protokollit, pra, kjo që sapo ju
5 thashë është thjeshtë një prej shembujve.

6 Por, ne sugjerojmë që do të ishte më mirë që të bëhet ky
7 parashikim se në qoftë se kjo kompetencë ekziston edhe në
8 qoftë se nuk ngrihet asnjëherë një rast i tillë, megjithatë,
9 domethënë mund të jetë i dobishëm. Se në qoftë se kemi qoftë
10 eshë një rast të vetëm do të ishte i justifikuar.

11 Komenti i fundit që kam për këtë temë është që miratojmë
12 propozimin e ZPS-së sa i takon propozimit të ndryshuar të
13 kornizës për 5(b)(2), pra, që Zyra për Mbrojtjen e
14 Dëshmitarëve duhet që të jetë e përfshirë në qoftë se është e
15 nevojshme. Pra, kjo është një praktikë të cilën ne e kemi parë
16 në GJPN po edhe në gjykata të tjera, pra, Zyra për Mbrojtjen
17 dhe Sigurinë e Dëshmitarëve është një element i rëndësishëm
18 dhe si rezultat duhet të jetë i përfshirë në këtë proces.

19 Lidhur me pyetjen 7, në qoftë se palët dhe pjesëmarrësit
20 mendojnë që modeli i GJPN-së është i përshtatshëm për t'u
21 zbatuar dhe këtu? Mendimi ynë është që ky është një model i
22 mirë, pra, është një model i cili është përdorur me çështjet
23 që cilat kanë pasur kompleksitet të konsiderueshëm, kështu që
24 mendojmë që është një model i mirë për t'u zbatuar dhe këtu.
25 Pra, ndryshime për Statusin e Dëshmitarëve të Dyfishtë është

1 një prej gjërave të tjera që mund të përfshihen dhe siç e
2 sqaruar do të ishte mirë që edhe Zyra për Mbrojtjen e
3 Dëshmitarëve të ishte e përfshirë.

4 Sa i takon pyetjes 8, që është edhe pyetja e fundit e
5 juaja, i nderuar Gjykatës: në qoftë se diskutimet *inter partes*
6 duhet të realizohen apo jo. Ne mendojmë që do të ishte shumë
7 mirë që të organizoheshin këto organizime të tilla. Ne jemi të
8 lumtur që të marrim pjesë në diskutime *inter partes* pasi i
9 mendojmë ato si mënyrë për të promovuar një rezultat
10 përfundimtar i cili do të ishte më i pranueshëm nga të gjitha
11 palët.

12 Kështu që, në përfundim më lejoni të them, që jemi të
13 lumtur që të angazhohemi më tepër në diskutime *inter partes*.

14 Këto ishin përgjigjet e mia, në qoftë se keni ndonjë
15 pyetje, ju lutem, më thoni.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Laws.

17 Tani le të vijojmë me Mbrojtjet.

18 Zoti Kehoe, fjala për juve. Keni 15 minuta në
19 dispozicion.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni, i nderuar
21 Gjykatës, dua që të diskutoj lidhur me ligjshmërinë e të
22 gjithë procesit, por dua që të flas për pesë minuta me kolegun
23 tim për të folur për protokollin e GJPN-së në qoftë se nuk
24 është e mundur.

25 Në fillim fare, më lejoni të them që Mbrojtja ka vendosur

1 mbrojtje [e pakuptueshme] ka vendosur që të ketë këtë qasje
2 mbrojtëse dhe kam përshtypjen që --

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Prokuror, ju lutem.

4 Zoti Kehoe, përpiquni që të përqendrohni tek gjerat që
5 diskutuam këtu. Ju lutem, mos të humbim kohë. Dhe ju lutem,
6 vijoni me përgjigjen e protokollit.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Sa i takon integritetit të sistemit,
8 pranisë së ZPS-së dhe do të futemi pak në më shumë detaje për
9 sa i takon kësaj pranie por do të doja që të sjellja në
10 vëmendjen e kësaj Gjykate që ambasadori Everts lidhur me këtë
11 Prokurori ka thënë që: "E gjithë tërësia e deklaratave duket
12 sikur reflekton një interes më të vogël për sa i takon
13 informacionit shfajësues në krahasim me informacionin
14 inkriminues".

15 Kjo është dukshëm në kundërshtim me deklaratën që u bë
16 nga ZPS-ja sa i takon integritetit të sistemit dhe duket sikur
17 ZPS-ja në vetvete nuk është se është në pozicionin për ta
18 thënë këtë gjë. Pra, mënyra sesi e shikon Prokuroria këtë
19 situatë, është një mënyrë që ju volitet vetëm atyre dhe mënyra
20 e të kërkuarit të intervistave dhe intervistimi i dëshmitarëve
21 pa praninë e Mbrojtjes; ne nuk kemi qenë të pranishëm kur janë
22 bërë intervistat e Mbrojtjes që në nëntor të vitit 2020. Dhe
23 janë bërë shumë të tilla, sepse ne kemi marrë një numër të
24 madh të deklaratave të dëshmitarëve gjatë muajve të fundit.

25 Kështu që, sigurisht që unë dua të flasë gjithashtu edhe

1 për barazinë e armëve ose barazinë e palëve. Dhe besoj, i
2 nderuar Gjykatës, që jeni dakord me mua që nuk ka barazi të
3 palëve vetëm kemi qëndrimin e ZPS-së që do që të diktojë
4 pozicionin e saj.

5 Ndryshe nga TPNJ-ja, GJPN-ja, tribunalet e tjera
6 ndërkombëtare, këtu flasim për një gjykatë e cila është
7 Gjykatë e Kosovës, është një gjykatë e cila diktohet nga
8 dispozitat që duhet të ndiqen dispozitat e Gjykatës Evropiane
9 të të Drejtave të Njeriun dhe kjo është shumë e qartë në
10 kuadrin e kësaj Gjykate.

11 Dhe dua të citoj këtu çështjen Dayanan kundër Turqisë, ku
12 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut foli për sa i takon
13 pjesës së marrjes në pyetje është që:

14 "Procesi i drejt gjyqësor kërkon që Mbrojtja të
15 përfshihet në të gjithë gamën e shërbimeve, përfshirë këtu
16 edhe ndihmën ligjore. Në këtë kuadër, Mbrojtja duhet që të
17 sigurojë pa kufizime aspektet thelbësore të Mbrojtjes së këtij
18 personi, përfshirë këtu diskutimin e çështjes, organizimin e
19 mbrojtjes, mbrojtjen e provave të favorshme për të akuzuarin
20 dhe përgatitjen për marrjen në pyetje".

21 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut thotë: "Duhet
22 që marrja në pyetje të bëhet pa kufizime".

23 Ndërkohë që ZPS-ja mundohet që të imponojë përpara
24 Gjykatës dhe ekipeve të Mbrojtjes që të vendosë shumë
25 kufizime. Le të fillojmë që në fillim dhe është me interes, në

1 fakt, që të lexohen parashtrimet e tyre sepse ata i
2 konsiderojnë dëshmitarët në listat e tyre të dëshmitarëve si
3 dëshmitarët e tyre. Nuk dua që të përsëris të gjithë
4 jurisprudencën që kam cituar në parashtrimet që ju kemi
5 dorëzuar i nderuar Gjykatës, por dëshmitarët në listën e
6 dëshmitarëve të ZPS-së nuk janë dëshmitarët e ZPS-së. Janë
7 dëshmitarë dhe pikë. Këto janë dëshmitarë të cilët duhet të
8 diskutohen dhe të merren në pyetje nga të gjitha palët.

9 Kur shohim ligjshmërinë dhe kur shikojmë atë se çfarë
10 rezulton këtu, pra, këtu kjo është një tjetër shtresë
11 paligjshmërie që ZPS-ja po mundohet që të imponojë mbi
12 Gjykatën. Kemi 326 dëshmitarë. Thujse 50 për qind e këtyre
13 dëshmitarëve kanë masa mbrojtëse sipas rregullës 80. Kam
14 përshtypjen që është 48 pikë diçka. Pra, 157 persona,
15 dëshmitarë nga 326 kanë masa tilla. Ndërkohë 103 janë
16 tërësisht anonimë, ndërkohë që nxjerrjet e dokumenteve vijnë
17 në momente të ndryshme dhe parashikohen që të jepen ndoshta 30
18 ditë përpara fillimit të gjykimit apo në kohë të tjera.

19 Pra, kemi këto masa mbrojtëse për dëshmitarët tani, pra,
20 kemi 157 nga 326 i kanë këto masa të kufizuara tani tek sa
21 flasim. Ndërkohë tani ZPS-ja ajo çfarë do të bëjë është që ta
22 zgjerojë fushën e veprimit të tyre dhe të vendosë kufizimet e
23 veta për protokollin për t'i shtruar, për t'i zgjeruar dhe për
24 dëshmitarë të tjerë që mund të jenë zyrtarë, qeveritarë,
25 zyrtarë ndërkombëtarë, persona të cilët vijnë, për shembull,

1 nga Britania, nga Gjermania, Franca, oficerë ushtarakë,
2 persona, gjeneralë të cilët kanë dalë në pension në ushtrinë e
3 Mbretërisë së Bashkuar. Janë nën masat mbrojtëse të cilat po
4 parashtrohen këtu në Gjykatë nga ZPS-ja. Pra, dëshmitarët në
5 vetvete përfaqësohen nga avokatët.

6 Kam lexuar një intervistë dje së bashku me kolegun tim,
7 zotin McCloskey, dëshminë e një dëshmitari që përfaqësohej nga
8 një avokat goxha i aftë e i zoti, ka qenë avokat në Mbretërinë
9 e Bashkuar për më shumë se 40 vjet dhe padiskutim që bën shumë
10 nga ç'lexuam, për të mbrojtur interesat dhe për të mbrojtur
11 dëshmitarin në fjalë. Pra, nga të gjithë këto persona ZPS-ja
12 tani po mundohet tani të përjashtojë Mbrojtjen që të bëjë
13 intervistimin e tyre.

14 Tani le të kalojmë tek arsyeja pse e kërkon ZPS-ja një
15 gjë të tillë. ZPS-ja thotë që kërkon që të shmangë
16 ritraumatizimin e viktimave dhe të sigurojë mirëqenien fizike,
17 psikologjike të tyre.

18 A po thotë me seriozitet ZPS-ja që gjeneralët, që
19 personat që kanë punuar me ushtrinë angleze ose të vendeve të
20 tjera, duan që të kenë që të mbrohet ana psikologjike,
21 mirëqenia e tyre? Sigurisht që jo. Ajo çfarë kërkon ZPS-ja
22 është e tejkaluar nuk është absolutisht në përputhje me
23 dokumentet dhe me praktikën nga gjykatat ndërkombëtare dhe
24 është qartazi në kundërshtim me praktikën gjyqësore të
25 Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

1 Sa i takon Mbrojtjes së dëshmitarëve ose vendosjes së
2 dëshmitarëve të Prokurorisë që janë nën shumë presion për të
3 provuar patriotizmin e tyre përmes bashkëpunimit, domethënë,
4 këto janë disa prej elementeve të cilat unë i kapa nga
5 përgjigja e kohëve të fundit, përgjigja që sapo dha ZPS-ja.
6 Megjithatë, këto janë thjesht retorikë, nuk japin asnjë provë.
7 Nuk ka asnjë indikator për dëshmitarë të cilët janë dëmtuar,
8 janë dëmtuar psikologjikisht, fizikisht e ku ta di unë.

9 Pra, a kemi filluar ne që të fillojmë intervistat në
10 Kosovë, i nderuar Gjykatës? Unë thashë në konferencën e fundit
11 për ecurinë e çështjesh që kemi filluar. Zoti McCloskey ka
12 kryer vetë disa intervista në Kosovë gjatë majit të fundit pak
13 a shumë. Dhe besoj që nuk ka pretendime këtu kundër zotit
14 McCloskey sa i takon intervistave që ka kryer ai. Kështu që i
15 gjithë argumenti që ekziston këtu që ka një spektër dëmtimi të
16 dëshmitarëve nuk ka pikë vlere, nuk është i mbështetur fare në
17 fakt.

18 Dhe meqenëse ra fjala çdo pretendim që kemi ngritur
19 kundër ZPS-së dhe të gjitha pretendimet tona janë të gjitha të
20 vërteta. Megjithatë, le t'i lëmë mënjanë këto, më lejoni të
21 them që nuk ka pasur asnjë provë materiale ose të asnjë lloj
22 natyre që na është sjellë ne në vëmendjen tonë ose ju është
23 dërguar juve, i nderuar Gjykatës, që të tregojnë që dëshmitarë
24 pra, që prej momentin e Aktakuzës në vitin 2020, pra, nuk kemi
25 asnjë provë të vetme që tregon që një person që është pjesë e

1 bankës së dëshmitarëve që është cenuar.

2 Por, kjo është një mënyrë për të treguar që ata duan që
3 të kenë kontroll të dëshmitarëve tanë dhe duan që gjërat t'i
4 bëjnë siç duan ata vetë. Pra, duan të kenë kontroll mbi
5 dëshmitarët e tyre, dëshmitarët tanë. Ndërkohë që duan që të
6 jenë të pranishëm kur ne do të flasim me dëshmitarët e ZPS-së.
7 Dhe keni parasysh që bëhet fjalë jo për pak dëshmitarë por për
8 326 dëshmitarë.

9 Pra, ata pretendojnë që këtë po e bëjmë për të shmangur
10 ritraumatizimin e dëshmitarëve. Në qoftë se do t'i referohemi
11 rregullit 80. Dhe, në qoftë se do të flasim, për shembull, për
12 vendimin tuaj, rregulli sa i takon masave mbrojtëse në
13 rregullin 80, 81 është dhënë që në dhjetor. Ka kaluar koha për
14 të diskutuar këtë çështje.

15 Jo vetëm kaq, por edhe më tej. Në mënyrë që të flasim për
16 masa mbrojtëse, rregulli 80(2) kërkon pëlqim. A është marrë
17 ndonjë pëlqim nga ZPS-ja sa i takon këtyre dëshmitarëve? Këta
18 gjeneralët në ushtritë angleze ose diplomatët nga Belgjika,
19 Franca, Gjermania e gjetkë, ata a e kanë dhënë pëlqimin e tyre
20 për të gjithë këtë? Në çdo parashtrim që na është dhënë nga
21 Prokuroria, nuk kam parë asnjë gjë të tillë. Dhe sigurisht kjo
22 është një kërkesë që rrjedh nga rregulli 80(2). Unë dyshoj që
23 asnjë pëlqim as nuk është dhënë dhe as nuk është kërkuar.

24 Në fakt, unë parashtroj përpara jush, zoti Gjykatës, që
25 asnjë pëlqim nuk është dhënë edhe për Mbrojtjet që kanë

1 përfaqësuar dëshmitarët. Domethënë as për këtë nuk është
2 kërkuar pëlqim për masat mbrojtëse. Pra, thjesht bëhet fjalë
3 për qëndrimin e ZPS-së që ne duam që gjërat të bëhen ashtu siç
4 duam ne dhe do duam që t'ju imponojmë qëndrimin tonë juve.

5 Sa i takon dëshmitarëve që përfaqësohen nga zoti Laws.
6 Nuk ka problem atje. Pra, nga aspekti etik neve duhet që të
7 kontaktojmë me zotin Laws në qoftë se mendojmë që duhet
8 kontaktuar me këtë dëshmitar. Në qoftë se dhe ne mendojmë që
9 duhet të flasim me një dëshmitar të tillë. Për këtë arsye ne
10 kërkuam që identiteti i dëshmitarëve të dyfishtë të dërgohej
11 përpara Gjykatës dhe për këtë bëmë parashtrim dje. Sepse në
12 momentin kur ta dimë se kush janë këta dëshmitarë dhe ZPS-ja e
13 di se kush janë këta dëshmitarë, atëherë na duhet që të
14 kalojmë nga zoti Laws, gjë e cila është e drejtë, një gjë të
15 tillë do të duhet ta bënim në çdo juridiksion.

16 Po as kjo nuk mbulohet, nuk trajtohet nga parashtrimi i
17 ZPS-së. Megjithatë nuk dua që të përmend të gjitha gjërat që i
18 kemi shkruar në parashtrim por protokolli cenon gjykimin e
19 drejtë. Ajo çfarë ndodhë është që ZPS-ja të vendosë qëndrimin
20 e vet, të na imponojë dëshirën e vet. Nuk ka barazi të palëve
21 këtu. Ndërkohë neve nuk na lejon që të vijojmë dhe të shohim
22 në brendësi se cilët janë dëshmitarët ose hetimet e tyre sepse
23 hetimet e tyre nuk po vijnë.

24 Dhe nga ana tjetër, ZPS-ja po ndërhyr me të drejtën e të
25 akuzuarit për të mos inkriminuar veten. Dhe ndërkohë ZPS-ja po

1 shkel në terrenin tonë. Ndërkohë që një gjë e tillë është
2 tërësisht në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës
3 Evropiane të të Drejtave të Njeriut sipas së cilës ne duhet që
4 të funksionojmë pa kufizime dhe e vetmja gjë që kërkon ZPS-ja
5 që të bëhet është që të vendosë kufizime.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Keni vetëm 15 minuta.

7 Në qoftë se doni që t'i jepni fjalën bashkavokatit që të
8 flasë duhet t'ia jepni tani se s'keni dhe shumë kohë në
9 dispozicion.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Pasja e këtij protokolli është
11 shkelje e rregullit 104(5).

12 E sa i takon ligjshmërisë dua që t'ia jap fjalën kolegut
13 tim.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Prokuror.

15 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Ju lutem, kam diçka për të
16 thënë.

17 Mbrojtja e Thaçit sapo bëri pretendime kundër ZPS-së të
18 cilat nuk janë të vërteta edhe një herë, zoti Kehoe, iu
19 referua deklaratës së zotit Everts që u parashtrua herën e
20 mëparshme në konferencën e mëparshme.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Prokuror.

22 Shkurtimisht. Keni më pak se një minutë për t'u
23 kundërpërgjigjur.

24 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Edhe njëherë avokati nuk
25 foli për pjesët fajësuese edhe për efektin që zotit Everts i

1 është kërkuar në fund të intervistës nga ZPS-ja në qoftë se ai
2 dëshiron që të japë informacion shtesë apo në qoftë se do që
3 ta plotësojë ose ta ndryshojë deklaratën e vet. Zoti Everts
4 nuk e bëri një gjë të tillë dhe të sugjerosh që rëndësia e
5 deklaratës së tij është shumë e madhe si për mbajtjen në
6 paraburgim apo për sa i takon arsyeve të tjera është e
7 pandershme dhe është deluzive gjithashtu.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Kehoe, 50 sekonda.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Neve qëndrojmë në të njëjtin
10 pozicion. Përsëri themi dhe sot, siç thamë herën e mëparshme,
11 që ZPS-ja nuk na e bëri të ditur këtë informacion, nuk e
12 nxorët këtë informacion megjithëse kishte detyrën që të na
13 jepte çdo informacion të tillë.

14 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Më lejoni të them që prej
15 momentit kur ka filluar në gjykatë ky proces gjykimi, kam
16 dëgjuar më shumë akuza për sjellje të pandershme, të padenjë
17 ndaj Prokurorisë sesa kam dëgjuar në të gjithë eksperiencën
18 time.

19 Ne kemi parashtrimet e zoti Thaçi sot të cilat nuk
20 përkojnë me parashtrime të tjera të cilat ata kanë bërë gjatë
21 vitit të shkuar.

22 Kështu që i kërkohet Mbrojtjes së zoti Thaçi që të japë
23 përgjigjen lidhur me këto dhe të mos i kthehet gjërave të
24 cilat i ka zgjidhur më parë. Sepse në qoftë se ti thua që ke
25 15 muaj që merresh me hetime është tjetër gjë po të thuash që

1 ke vetëm një muaj që merresh me hetime. Këto janë gjëra
2 serioze. Kështu që do t'i kërkojmë zoti Kehoe që të vazhdojë
3 dhe të japë shpjegime lidhur me këtë temë dhe të mos të bëjë
4 më pretendime të pabazuara ndaj nesh.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po ia jap fjalën zotit
6 Misetic. Nuk po e vazhdojmë këtë mosmarrëveshje. E thashë
7 qartë në urdhrin tim përpara se të nxjerr vendimin tim.

8 Zoti Misetic, keni fjalën.

9 Më falni, në qoftë se jua shqiptoj gabim emrin, në
10 konferencën e mëparshme bëra shumë gabime dhe për këtë ju
11 kërkoj ndjesë.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk keni
13 nevojë të më kërkonin ndjesë, i nderuar Gjykatës.

14 Po e filloj duke thënë sa vijon. Në nëntor të vitit 2020,
15 ZPS-ja tha që do të ishte gati për gjyq në verën e 2021-shit.
16 Sigurisht që pastaj vazhduan, siç u pa, me nxjerrjen e
17 identiteteve dhe deklaratave të dëshmitarëve duke menduar në
18 atë kohë se do të fillonte gjykimi brenda shtatë muajsh.

19 Nuk ju kërkuam që të vendosnit ndonjë protokoll kur ata po
20 nxirrnin deklaratat e dëshmitarëve, supozimi bazë dhe
21 prezumimi i parashtrimeve të tyre që e bënë shumë të qartë sot
22 në mëngjes është se Mbrojtësit janë, në njëfarë mënyre, të
23 dyshimtë dhe ju duhet të na shikoni me dyshim si mbas
24 parashtrimeve të tyre mbase dhe ne do të ngatërrojmë si të
25 thuash provat do të fusim duart në prova.

1 I kujtoj ZPS-së dhe padyshim Gjykatës, se për t'u
2 kualifikuar si Mbrojtës, ne të gjithë avokatët e Mbrojtjes, të
3 gjithë jemi nënshtruar një procedure shumë strikte dhe me sa
4 di unë asnjë avokat i Mbrojtjes nuk ka pasur asnjë akuzë për
5 gjatë gjithë karrierës së tyre për të ndërhyrë në provat e
6 dëshmitarëve. Dhe jemi të kualifikuar për të vazhduar këtë
7 procedurë.

8 Pra, këto që thuhet që minojnë të gjithë protokollin
9 tregojnë që duhet t'i shikoni me dyshim avokatët e Mbrojtjes
10 që është kundër. Kjo bie ndesh me faktet e çështjes që jemi
11 njerëz të besueshëm.

12 Së dyti, fakti është se ka 15 muaj që çështja është në
13 hava nuk ka filluar pra. Dhe nuk jemi të qartë për pretendimet
14 apo akuzat e Prokurorisë lidhur me parashtrimet tona.

15 Parashtrimi ynë është që për 15 muaj ZPS-ja i ka dhënë, i
16 ka nxjerrë identitetet e dëshmitarëve. Me sa dimë ne nuk ka
17 pasur asnjë pretendim nga asnjë dëshmitar i ZPS-së për sjellje
18 të papërshtatshme me këta dëshmitarë nga ekipi i Mbrojtjes.

19 Ajo që dimë ne deri tani është se i vetmi problem që ka
20 ndodhur me sigurinë e një dëshmitari është nxjerrja nga ZPS-ja
21 e deklaratave të dëshmitarëve që u bënë publike në procedura
22 të tjera. Këto janë fatet e thjeshta.

23 Çështja bazë dhe ajo që ZPS-ja dhe Avokati i Viktimave që
24 u aludua nga zoti Kehoe, janë krahasimi me këto procedura me
25 ato të TPNJ-së. Theksojmë se procedurat e GJPN-së nuk

1 krahasohen me ato të TPNJ-së. Sepse ato nuk drejtoheshin nga
2 Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Kjo Gjykatë është
3 shprehimisht në bazë të ligjit për Dhomat e Specializuara dhe
4 Kushtetutës së Kosovës dhe, siç e tha zoti Kehoe në rastin që
5 citoi çështja kundër Turqisë, për të bërë punën tonë këtë
6 duhet ata bëjmë "pa kufizim" në mbledhjen e provave që janë të
7 favorshme për të akuzuarit dhe në përgatitjen për pyetje.

8 Së fundi, dua të them se supozimi apo sugjerimi i ZPS-së
9 dhe Mbrojtësit të Viktimave se detyrimet sipas protokollit do
10 t'i trajtojnë të dy palët në mënyrë të barabartë. Në fakt,
11 rregullat nuk janë bërë që t'i trajtojnë detyrimet për
12 nxjerrje në mënyrë të barabartë.

13 ZPS-ja ka një barrë më të rëndë për të nxjerrë materiale
14 krahasuar të akuzuarit me të pandehurit. Sepse të akuzuarit
15 nuk kanë detyrimin për të nxjerrë deklaratat e dëshmitarëve
16 përpara fillimit të çështjes paraqitjes së çështjes nga
17 Mbrojtja. Vetëm ato deklaratat që i akuzuari synon t'i përdorë.

18 Këto që u thanë na vënë në këtë pozitë dhe u vu në dukje
19 qartë nga ZPS-ja. ZPS-ja, sot në mëngjes tha apo këtë pasdite
20 tha: ata duan që ju të urdhëroni nxjerrjen e deklaratave dhe
21 shënimeve të cilat janë marrë gjatë intervistave të
22 dëshmitarëve të ZPS-së. Kjo është një shkelje e qartë e
23 rregullave.

24 Nuk ka detyrim i akuzuari t'i nxjerrë dëshmi Prokurorisë
25 të cilat mund të përdoren kundër tij në procedura. Është një

1 procedurë e qartë, një shkelje e qartë e të drejtës së tija
2 për të mos u inkriminuar. Tani Prokuroria thotë që: ju,
3 Mbrojtja, duhet të ndërmerri hapa që ndryshe nuk do t'i
4 ndërmerri. Për shembull, të intervistojmë një dëshmitar, nuk
5 pëlqen ajo që thotë dëshmitari, nuk kemi pse të marrim një
6 dëshmi të tillë.

7 Kurse tani, sipas protokollit, thuhet se duhet të krijoni
8 deklarata, duhet t'ia bëni të qartë t'ia nxirrni ZPS-së të
9 cilat ajo pastaj mund t'i përdorë më vonë kundër jush. Më
10 vonë. Pra, në këtë mënyrë e detyron të akuzuarin të krijojë
11 dëshmi të cilat potencialisht mund të përdoren kundër tij.

12 Ndërsa kjo mund të përdoret në GJPN, por nuk ka ndonjë
13 vendim që të thotë që këto përputhen me Konventën Evropiane të
14 të Drejtave të Njeriut dhe nuk janë gjetur të vlefshme nga
15 GJEDNJ. Nuk është ky qëndrimi i kësaj Gjykate. Kjo Gjykatë
16 duhet të ndjekë Tribunalin Penal Ndërkombëtarë për Ruandën,
17 atë që ka thënë ai.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani po ju lë ju të
19 vendosni se kush do të përgjigjet.

20 Ju këmbëngulni në faktin se ky protokoll do të ishte, do
21 të binte ndesh me Konventën Evropiane për të Drejtat e
22 Njeriut.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Kur ne flasim për detyrimin për të
24 ndjekur nenin 12 dhe 53 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin
25 3(2) (a) të Ligjit. Që kërkohet që Gjykata e Kosovës të ndjekë

1 jurisprudencën e Gjykatës Evropiane, GJEDNJ-së.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E di. Po cili nen është?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Neni 6. E
4 drejta për një avokat dhe për një gjykim të drejtë. Po. Kjo
5 vjen nga e drejta për të pasur një avokat.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mendoni se protokolli i
7 GJPNJ-së apo modelet e ndjekura në çështjet e ndryshme do të
8 ishin ndryshe -- do të binin ndesh me KEDNJ-në?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Me sa dimë
10 ne, këto nuk janë cituar nga GJEDNJ-ja dhe GJPNJ-ja nuk ka
11 thënë që përputhen me KEDNJ-në. Për atë që protokolli kërkon që
12 të krijohen prova që mund të përdoren kundër tij, po, mendojmë
13 që do të shkelte KEDNJ-në.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Kur ju thoni që bie ndesh
15 me KEDNJ-në e keni fjalën vetëm për pikën konkrete që sapo
16 përmendët apo është më e gjerë se atë? Është parimi i
17 protokollit apo midis të dyve bëhet fjalë për faktin se ka një
18 parregullsi në hetimet e Mbrojtjes në fazën paraprake?

19 Z. MISETIC: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Në qoftë se
20 ne vihemi në pozitë që të zgjedhim, o të rrezikojmë krijimin e
21 një të dhëne, e një praktike që mund të apo një dokumenti që
22 mund të përdoret kundër të akuzuarit apo për intervistimin e
23 dëshmitarit, kjo e drejta për të hetuar del nga e drejta për
24 t'u përfaqësuar nga një avokat.

25 Duhet të diskutojmë të drejtat në bazë të konventave të

1 ndryshme, sepse ZPS-ja mund të vijë më vonë dhe mund të thotë
2 që dëshmitari ka thënë kështu-kështu. Pra, ne nuk e hetojmë
3 fare, që kjo pengon aftësinë tonë për të bërë kundërpjetje apo
4 pyetjet tona si palë, sepse nuk na është dhënë mundësia që të
5 takohemi me dëshmitarin, ta intervistojmë, të shikojmë se
6 ç'thotë ai.

7 Dhe kjo prek të drejta të tjera, në kuptimin që ZPS-ja do
8 të jetë e pranishme në dhomë. Po japim një shembull hipotetik,
9 për shembull, në qoftë se jemi aty gjatë një interviste të
10 dëshmitarit dhe ZPS-ja -- del një dëshmi që mund të jetë shumë
11 shfajësuese për të akuzuarin, ZPS-ja vendos, pra, si rezultat
12 që të ul numrin e dëshmitarëve që do të thërresë.

13 Duke qenë e pranishme, pra, në intervistën e dëshmitarit
14 ZPS-ja e vendos të mos e thërresë dëshmitar kurrë, ndërkohë
15 kur Mbrojtja e vendos të thërresë dëshmitarë që ishin në
16 listën e ZPS-së, kemi të bëjmë pastaj me një shkelje të
17 rregullit 104. Siç tha zoti Kehoe, ato janë futur në
18 territorin tonë në kampin e Mbrojtjes, tani kemi mundësi të
19 shohim se cilat janë ato prova të cilat ZPS-ja mund të dojë
20 t'i theksojë.

21 Ideja është kjo, që rregullat janë strukturuar në mënyrë
22 jo simetrike dhe kjo është pjesë e parashtrimeve tona.
23 Protokolli -- këta thonë -- ZPS-ja thotë gjithçka është në
24 rregull sepse ajo zbatohet për dy palë në mënyrë të barabartë.
25 Por rregullat nuk janë strukturuar kështu. Në këtë fazë barrën

1 e ka të gjithë Prokuroria. Ajo e ka të gjithë detyrimin për të
2 nxjerrë materiale. Mbrojtja nuk asnjë tani. Dhe 50/50 është
3 një shkelje e mënyrës sesi janë strukturuar rregullat.

4 Ka një arsye pse rregullat thonë ato që thonë. Nuk e
5 thonë që Mbrojtja duhet t'i nxjerri që në fillim deklaratat e
6 saja. Nëse i akuzuari për arsye të ndryshme nuk do t'i
7 paraqesë, t'i parashtrojë ato prova Gjykata nuk ka të drejtë
8 ta detyrojë.

9 Protokolli juaj tani e bën të nevojshme këtë, e detyron
10 të akuzuarin të paraqesë deklarata që ndryshe mund të mos dojë
11 t'i paraqesë. Ne parashtrojmë se kjo do të ishte një shkelje e
12 konventës.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Misetiç, në shumë
14 sisteme të Evropës, mbase shumica e tyre, nuk jam i sigurt,
15 Mbrojtja nuk ka as të drejtën të marri në pyetje dëshmitarë
16 përpara fillimit të gjyqit, përpara gjyqit apo përpara
17 gjykatësi hetimor të vendosë këtë.

18 Pra, e kam të vështirë të pranoj argumentin tuaj, pra, që
19 parimi i këtij protokolli do të binte ndesh me konventën apo
20 me Gjykatën Evropiane sepse kjo nuk i jep as të drejtën
21 Mbrojtjes të bëjë pyetje, të marrë në pyetje dëshmitarë.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Mund të jetë
23 ashtu, por i akuzuari ka të drejtë ta pyesë, t'i kërkojë
24 dëshmitarit të fusë të dëshmitarë të ndryshëm si pjesë e
25 hetimeve.

1 Nuk është kështu. Kurse këtu nuk është kështu. Ndërsa
2 mund të themi se po të ishim në një sistem të së drejtës
3 civile, Gjykatësi do t'i bënte të gjithë pyetjet dhe nuk do të
4 kishte ndonjë rrezik që i akuzuari të krijonte prova të cilat
5 mund t'i përdreshin kundër tij.

6 Ne jemi në një sistem tjetër ku ZPS-ja ka të drejtë të
7 hetojë çështjen e saj dhe i akuzuari ka të drejtë të bëjë,
8 hetojë dhe të krijojë provat e çështjes së tij. Dhe tani ju
9 kërkohet ajo që ju prodhoni mund të përdoret kundër teje, pra,
10 i thonë të akuzuarit në një procedurë përpara Gjykatës, që nuk
11 do të ndodhte edhe në një sistem të së drejtës civile,
12 pavarësisht nga çështja që do të diskutohej aty, kur të
13 akuzuarit nuk do të t'i kërkohej të prodhonte prova të cilat
14 nuk të ishin krijuar, të cilat mund të përdreshin kundër tij.

15 Pra, ideja është se në qoftë se kemi një sistem të
16 ndërtuar kështu, duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që i
17 akuzuari të ketë mundësinë të kryejë hetime dhe të mos vihet
18 në një pozitë ku të kryejë një hetim dhe të rrezikojë të
19 krijojë prova kundër tij apo të mos bëj fare hetime.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Misetic.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Një koment të fundit.

22 Zoti Misetic përmendi rregullin 104 dhe detyrimi që kemi
23 për të paraqitur informacion është që, aty thotë që:

24 "Mbrojtja në rast zgjedh të paraqesë çështjen e vet
25 duhet brenda një afati të përcaktuar nga Trupi Gjykues dhe jo

1 më vonë se 15 ditë përpara hapjes së çështjes”.

2 Sipas protokollit që paraqitet nga ZPS-ja, ata do të kenë
3 deklarata të dëshmitarëve përpara se Mbrojtja të ketë marrë
4 ndonjë vendim për paraqitjen e çështjes në shkelje të
5 rregullit 104(5).

6 Ky është regjimi i krijuar kur këto rregulla janë
7 formuluar, janë hartuar. T’i kthehemi shembullit që dha zoti
8 Misetic. Kemi një intervistë të një dëshmitari dhe dëshmitari
9 jep informata të cilat janë shfajësuese. Prokuroria vendos të
10 mos e paraqesë atë dëshmitar, atëherë Mbrojtja vihet në pozitë
11 për ta paraqitur ajo atë dëshmitar kur ZPS-ja ka deklaratat e
12 atij dëshmitari nga është biseda me avokatin e Mbrojtjes në
13 shkelje të rregullit 104(5).

14 Thjesht duke ndjekur rregullat, po të lëmë mënjanë
15 regjimin e TPNJ-së, GJPNJ-së, këto rregulla thonë atë që ne
16 duhet të bëjmë, kurse protokolli, kështu siç është formuluar,
17 është në shkelje të rregullit 104(3) bazuar dhe në atë
18 skenarin hipotetik të cilin e përmendi zoti Misetic.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] T’i kthehemi tani ekipit të
20 zotit Veseli. Kush do flasë? zoti Emmerson apo zoti Strong?

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Për
22 momentin jam unë.

23 A mund më lejoni të ngre dy-tre gjëra të përgjithshme sa
24 më shpejt që mundem nga lista e pyetjeve.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E keni brenda afatit 15

1 minutash e keni.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po. Do të
3 bëj çmos që të përfundoj brenda afatit që më keni dhënë.

4 Pikë së pari dhe këtë e kam në përgjithësi, ju ftoj të
5 shqyrtoni sesi argumentet, qëndrimi i paraqitur nga Prokuroria
6 mund të rakordohen me supozimin e detyruar të pafajësisë. Nuk
7 duket se është paraqitur në parashtrimet e saj, janë dy
8 propozime themelore bazë.

9 Që i akuzuari mund të dojë të ndërhyjë në drejtësi përmes
10 avokatit të tij; dhe e dyta, është një pretendim i
11 drejtpërdrejtë kundër mbrojtësit të të akzuarit. Sikur ato
12 nuk mund t'ua kesh besën të respektojnë Kodin e Sjelljes dhe
13 se kanë gjasa të ndërhyjnë tek dëshmitarët. Këto janë komente
14 fyese, nuk përputhen fare me rregullat dhe dua që ta trajtoj
15 sepse është një propozim shumë serioz.

16 Përpara se të vijmë aty, gjithsesi dua që t'ju ftoj ju, i
17 nderuar Gjykatës, të shikoni mënyrën sesi paraqitet çështja me
18 supozimin e prezumimin e pafajësisë, siç është paraqitur kohët
19 e fundit, i cili është respektuar në të gjitha vendimet që ju
20 keni dhënë. Pra, është një pohim shokues ky i Prokurorisë.

21 Së dyti, çështja kryesore është propocionaliteti i kësaj
22 që propozohet. Në fillim të parashtrimit, Prokurori tha që nuk
23 e dinte nëse e kishte të drejtën të bënte, të përfaqësonte
24 dëshmitarët viktimat. Ai nuk e ka këtë gjë, nuk e ka këtë të
25 drejtë.

1 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Pra, ne
2 duhet të shikojmë, siç thotë Prokuroria, se për çfarë është ky
3 protokoll dhe metodologjia e përdorur aty. Për të arritur
4 objektivin që pretendon se duhet të arrijë dhe po citoj
5 Prokurorinë "të shmangë ritraumatizimin e dëshmitarëve dhe të
6 ruaj integritetin, mirëqeniet e tyre fizike, psikologjike".

7 Çështja e parë është përse përfshin dëshmitarët jo
8 viktimat në këtë protokoll? Nuk ka arsye përveç faktit që siç
9 thonë ata që Mbrojtja do të bëjë përpjekje t'i korruptojë ata
10 në mënyra të ndryshme. Unë këtë e quaj jashtëzakonisht fyese
11 dhe mënyrën sesi e tha kolegu është për të qeshur dhe nuk
12 duhet marrë seriozisht. Në fakt, e kundërta është e vërtetë
13 lidhur me parashtrimet e Mbrojtjes.

14 Çështja e parë është: Çfarë kërkon proporcionaliteti në
15 kontekstin e një skeme që synon të shmang --

16 PËRKTHYESJA: U ndërpre. Nuk e dëgjoj mirë. Na falni.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Unë të dëgjoj, po dëgjojmë
18 zhurmë. Nuk e di si është puna. Është një mikrofon tjetër, e
19 ka dikush të hapur apo nuk e di. Ju lutem mbyllini të gjithë
20 mikrofonat dhe mbase do të rregullohet cilësia e zërit.

21 Zoti Emmerson, vazhdoni.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Pra, janë
23 cituar disa shembuj, siç është puna e ndërkombëtarëve që do të
24 thirren për të dëshmuar. Është e qartë se ky sistem që
25 propozohet nuk ndihet të jetë, nuk duhet të zbatohet dhe nuk

1 ka asnjë justifikim për ta zbatuar.

2 Më duket, me gjithë respektin, që minimumi duhet që të
3 përjashtoni çdo njeri që nuk pretendohet se është viktimë.
4 Sepse po flasim për 300 e ca -- nuk e mbaj mend numrin. 320
5 apo 360 dëshmitarë. Gjithçka që mund të bëhet për ta bërë
6 numrin të menaxhueshëm ndryshe do të vazhdojmë do të kemi një
7 vonesë prej dy vjetësh të tjerë.

8 Shumë prej nesh, sigurisht, nuk kanë dëshirë, do të
9 nguronin që të intervistonin dëshmitarë viktimë paraprakisht.
10 Jo në lidhje me ato që thuhet në Aktakuzë po për përvojat e
11 tyre personale. Në mënyrë realiste, është një ndërhyrje shumë
12 e madhe me Mbrojtjen lidhur me ata dëshmitarë që nuk janë
13 viktimë.

14 Për sa i takon procedurës përdorur në GJPN, duhet të kemi
15 shumë kujdes të kujtojmë dallimin midis procedurave ku ka
16 vetëm një gjykatë dhe atyre që ka dy palë, siç është rasti ynë
17 dhe kjo përputhet me nenin 6.

18 Pra, një proces i zakonshëm me një gjykatës, pra, me
19 gjithë mbrojtjet që ka do të ishte diçka që nuk do të përdorej
20 në rastin tonë. Sepse edhe të themi tani që meqë funksionon në
21 atë lloj sistemi do të funksiononte dhe në sistemin tonë me dy
22 palë kundërshtare, sepse të dy palët i paraqesin provat dhe
23 Gjykata merr pastaj merr vendimin. Gjithsesi ta pyesësh një
24 dëshmitar për diçka gjatë kundërpjësive për herë të parë mund
25 të jetë një çështje që ka të bëjë me protokollin por mund të

1 jetë një çështje me një burim të pavarur për të cilin ti e
2 pyet dëshmitarin. Kjo do të ishte një mjet i rëndësishëm për
3 të vlerësuar kredibilitetin e këtij dëshmitari dhe
4 besueshmërinë e dëshmitarit.

5 Është një proces ku secila palë duhet të paraqesë, por
6 duhet të ketë besim për t'i paraqitur çështjen e vet. Në qoftë
7 se Prokuroria thotë që nuk mund t'ia kesh besën Mbrojtjes, kjo
8 është për të qeshur. Kam frikë se i gjithë sistemi në këtë
9 rast do të binte, do të rrëzohej sepse gjithçka bazohet në
10 besimin midis palëve.

11 Dua të trajtoj një aspekt dhe pastaj do të vazhdoj, do
12 t'i kthehem çështjes -- pyetjeve tuaja. Nuk e di nëse ka
13 nevojë që t'u drejtohem në hollësi për propozimin që qesharak
14 të Prokurorisë dhe për çështjet që ka ngritur në Gjykatë të
15 hapur dhe për sjelljen e Prokurorisë në këto procedura, të
16 cilat në vetvete janë kërcënim për bashkëpunimin e
17 dëshmitarëve.

18 Pra, sipas asaj neve s'duhet të na e kesh besën, jemi
19 njerëz që jemi jo të duhur. Realiteti, siç e dini ju, është se
20 çështjet e ngritura nga Mbrojtja kundër Prokurorisë lidhen me
21 deklarata jo të sakta lidhur me kohëzgjatjen e procedurave për
22 periudhën paraprake dhe lidhet me shanset e lirit paraprak.
23 Prokuroria e [ka] keqorientuar Gjykatën në shumë mënyra dhe
24 Prokuroria ka adresuar takimin e ministrit e ambasadorëve
25 evropianë lidhur me të akuzuarit.

1 Pra, kemi pasur zhvillime të tmerrshme lidhur me sjelljen
2 e Prokurorisë. Mbase toni që kam përdorur unë mund të ketë
3 reflektuar ato që unë kam ndjerë që është shok, një tronditje
4 e vërtetë, në mënyrën sesi Prokuroria është sjellë gjatë
5 gjithë kësaj kohe dhe si është lejuar të sillet.

6 Por të thuash se unë jam një person që do të kryeja krim
7 në përgatitjen e çështjes së Mbrojtjes do të ishte e turpshme
8 dhe një shembull i mirë sesi Prokuroria ka humbur çdo arsye,
9 çdo logjikë dhe është e dëshpëruar.

10 Për sa i takon protokollit, siç them, mund të filloj me
11 propozimin që është tepër, tepër i gjerë lidhur me dëshmitarët
12 që ajo mbulon dhe duhet të shkurtohet shumë dhe të përfshijë
13 ata dëshmitarë të cilët mund të jenë vërtetë të traumatizuar,
14 mund të ritraumatizohen vërtet po të pyeten përsëri nga
15 publiciteti që rrethon dhënien e dëshmisë së tyre.

16 Dhe kjo s'ka të bëjë më intervistimin e tyre nga
17 Mbrojtja, por ka të bëjë me të gjithë procesin të cilit ata po
18 i nënshtrohen, sidomos ata që vuajnë nga pas ngjarjeve, post
19 traumave, pra. Ne jemi të gatshëm t'u japim atyre të gjithë
20 mbështetjen psikologjike dhe sociale që mund të kenë nevojë.

21 Sigurisht, kemi të bëjmë me një situatë ku Prokuroria ka
22 humbur fokusin e saj. Siç thashë herën e fundit, po të marrim
23 -- po të pyeten të gjithë dëshmitarët e Prokurorisë mund të
24 vazhdonte katër-pesë vite të tëra gjyqi.

25 Prokuroria thotë çfarë i do qejfi për të zgjidhur

1 problemet me afat të shkurtër pavarësisht nëse ka ndonjë të
2 vërtetë në parashikimin që ata bëjnë. Dhe këtë e kemi parë
3 shumë herë.

4 Ne sugjerojmë që Prokuroria nuk po merret me çështjet
5 bazë që kanë të bëjmë me ritraumatizimin. Po krijon një
6 protokoll që mbulon 360 dëshmitarë, ndërkombëtarë, punonjës
7 policie, njerëz të tjerë që gjoja tremben. Në të njëjtën kohë
8 këtë njerëz kanë folur publikisht që janë intervistuar nga
9 ZPS-ja. Janë kthyer në Kosovë edhe e kanë bërë të njohur që
10 kanë dhënë dëshmi, janë intervistuar nga Prokuroria. Nuk duket
11 se janë njerëz që kanë frikë, janë trembur dhe kanë frikë.

12 Pra, kam frikë se po ju japin gjëra të cilat nuk lidhen
13 fare me nevojën për një protokoll me këtë lloj fushëveprimi
14 kaq të gjerë me gjithë këto dëshmitarë.

15 Pyetjen e parë që bëni ju në lidhje me bazën ligjore dhe
16 me gjëra të tjera, me tribunale të tjerë me të cilin
17 krahasohen. Siç e thoni edhe ju pyetja që bëhet, në fakt,
18 pyetja që ju i bëni Prokurorit pa pasqyruar as aspektet e
19 tjera, duket se nuk pasqyron proporcionalitet në një rast të
20 tillë.

21 Shohim këtu raste ku numrat e dëshmitarëve kanë qenë
22 shumë të vegjël në krahasim me çështjen që kemi përpara. Mund
23 t'ju jap statistikën, sigurisht, nëse i gjej. Më falni.
24 Megjithatë, mund t'i kthehem pastaj. I kisha diku këtu. Ju
25 kërkoj ndjesë, e humba statistikën.

1 Po flasim diku nga 40 deri në 60 dëshmitarë, sigurisht,
2 nuk ishin objekt të gjithë të protokollit. Vetëm në rastet
3 ekstreme ato që ju paraqiten, pra, nga këndvështrimi që
4 kërkohet sa i takon intervistimit të dëshmitarëve është shumë
5 i dobishëm.

6 Por kemi të bëjmë një mendësi komplet tjetër në rastin e
7 TPNJ-së, e cila vlente për Ballkanin përfshirë këtu edhe
8 Kosovën. Dhe besoj se e gjejmë bazën tek një prej çështjeve
9 gjyqësore aty. Është një parim, në fakt, që e gjejmë në të
10 gjitha proceset gjyqësore me ballafaqim ku të dyja palëve tu
11 jepet një e drejtë e barabartë për të intervistuar dhe jo që
12 këtë të drejtë ta ketë vetëm Prokuroria, por ta bëjë edhe
13 Mbrojtja njësoj si Prokuroria dhe pa pasur që ta dijë
14 Prokuroria dhe të tjerët.

15 Ka një frazë që përdoret shumë shpesh për botën mbi të
16 cilën mbështetet ky proces. Në fakt qasja e ndjekur nga
17 Gjykata Penale Ndërkombëtare kërkon që pala thirrëse të ketë
18 një interes zotërimi mbi një dëshmitar.

19 Por qasja e ndjekur nga TPNJ-ja është e ndryshme dhe kjo
20 ka dalë dhe në vendimin Mrksic që është i 30 korrikut 2003,
21 paragrafi 13, është një vendim i marrë mbi apelin e ndërmjetëm
22 të mbrojtjes mbi komunikimin me dëshmitarë të mundshëm të
23 palës kundërshtare. Dhoma Gjyqësore në atë rast e rrëzoi në
24 fakt kërkesën e mbrojtjes për vendosjen e rregullave të
25 komunikimit me këta dëshmitarë.

1 Pastaj Dhoma e Apelit e la në fuqi vendimin që nuk duhet
2 të kishte në përgjithësi një protokoll të tillë, por e
3 thoshte:

4 "Prokuroria nuk e kishte detyrimin që ta detyronte këtë
5 person të intervistohet".

6 Paragrafi 3 - më fal- 18, 19 i vendimit thuhet pikërisht
7 kjo gjë. Pra, që nuk ka një rregull. Në fakt, as në
8 Rregulloren e Dhomave të Specializuara të Kosovës nuk një
9 rregull e cila do ta kërkonte një gjë të tillë. Kjo sigurisht
10 do të kërkonte marrjen e një vendimi rast pas rasti për
11 dëshmitarët.

12 Sigurisht, një dëshmitar që nuk dëshiron të intervistohet
13 nga Mbrojtja ka të drejtën të refuzojë. Çdo dëshmitar që ka të
14 drejtë për Mbrojtësin e Viktimave kështu e ka këtë të drejtë.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Emmerson, mund të keni
16 kaluar 19 minuta.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po kam
18 filluar në 14:47. Kështu që më mbaron kohë në 15:17, kështu që
19 tani është 15:06.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Është 15 minuta për avokat.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Ashtu?
22 Paskam marrë gabim 15. Mirë, në rregull atëherë. Unë gjithsesi
23 fundit po i afrohesha.

24 Këto ishin pak a shumë pikat.

25 Është çështje legaliteti sa i takon bazës së dispozitës,

1 protokollit më saktë dhe kjo ishte pyetja juaj e parë.

2 Pyetja juaj e dytë, më duket se unë i jam përgjigjur,
3 nëse kjo duhet zbatuar apo jo për të gjithë dëshmitarët si
4 protokoll.

5 Pyetja e tretë është pyetje që i drejtohet Prokurorisë.

6 Pyetja e katërt. Ekipet e Mbrojtjes a kanë ndërmend të
7 organizojnë intervista të përbashkëta? Nuk kemi rënë dakord me
8 ekipet e Mbrojtjes, megjithatë kështu po më duket se nuk ka
9 ndonjë forcë bindëse në këtë parashtrim lidhur me këtë.

10 Po kështu, siç e thashë tashmë, mungon propocionaliteti
11 dhe precizioni, masat e propozuara nuk janë praktike. Ne
12 sugjerojmë që TPNJ-ja është një qasje më e përshtatshme në
13 kuadrin e procedurës ballafaquese.

14 Por ne e kuptojmë, sigurisht, që në qoftë se i nderuar
15 Gjykatës mendon se është i domosdoshëm vendosja dhe zbatimi i
16 një protokollit lidhur me kategori të caktuara sepse përndryshe
17 pastaj i bie që të përfshihen të gjithë atëherë kjo të
18 zbatohet për një kategori shumë të ngushtë nga kategoria që ka
19 kërkuar Prokuroria.

20 Mendoj që kaq kisha.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti
22 Emmerson.

23 Zoti Prokuror, deshët që të merrnit fjalën? Shumë shkurt
24 sepse duhet të bëjmë një pushim për hir të përkthyesve përpara
25 se të vazhdojmë me ekipet e tjerë të Mbrojtjes.

1 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
2 Gjykatës.

3 Dëshiroj që të them dy gjera të tjera krahas atyre që
4 thashë në përgjigje të parashtrimeve që u bënë deri tani.
5 Premtoj që do flas më shkurt nga më përpara, por këtë do ta
6 bëj pasi të flasim ekipet e Mbrojtësve të Thaçit dhe të
7 Veselit.

8 PËRKTHYESI: Përkthyesit u kërkojnë të gjithë folësve të
9 tjerë të fikin mikrofonat.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Më duket se zgjidhëm dhe
11 problemin e zhurmës që dëgjonim herë pas here.

12 Është ora 16:09. Do të rikthehem këtu mbas 21 minutash,
13 në 16:30. Ku do i japim fjalën Mbrojtjes së Selimit.

14 --- Pauza fillon në orën 16.09

15 --- Seanca rifillon në orën 16.33

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ja jap fjalën tani z.
17 Tully.

18 Z. TULLY: [Përkthim] Do përpiqem që të flas sa më shkurt.
19 E di që avokati i z. Thaçi dhe z. Veseli kanë mbuluar një
20 pjesë të rëndësishme të pikave. Mbështesim ato të tyre dhe do
21 të shtojmë diçka pa përsëritur.

22 Së pasi do t'ju drejtohem pyetjeve tuaj.

23 Pra pyetja juaj e parë sa i takon bazës mbi të cilën
24 mbështeten parashtrimet e ZPS-së. Ne mendojmë se rregulla më
25 me rëndësi që është cituar këtu është rregulla 80. Ne jemi në

1 dijeni të parashtrimeve të para dhe parashtrimeve të dyta me
2 shkrim të Prokurorisë. Ato nuk janë mbështetur tek rregulla
3 80, e kanë përmendur por nuk janë mbështetur drejtpërdrejtë
4 tek ajo dhe kjo është vërejtur edhe nga mbrojtësi i z. Thaçi
5 ditën e hënë.

6 Megjithatë, thelbi i këtyre propozimeve për protokollin
7 ka të bëjë elementet e rregullës 80. Dhe kjo do të përbënte
8 edhe bazën nëse do të miratohej një protokoll i tillë.

9 Shkurtimisht dua të themi diçka lidhur me bazën ligjore
10 të masave mbrojtëse. Sipas rregullës 80 për nga natyre që kanë
11 masat mbrojtëse rrezikojnë që të kufizojnë të drejtat e të
12 akuzuarve, për shembull, shtyrja e nxjerrjes për shembull mund
13 të pengojë të drejtën e të akuzuarve për t'u përgatitur dhe
14 për të zhvilluar seancat në formë publike. Prandaj dhe masat
15 mbrojtëse duhet të përbëjnë përjashtim nga rregulli dhe
16 sidomos nuk duhet të cenojnë të drejtat e të akuzuarve. Ne
17 parashtrojmë se do të shkeleshin këto drejtat nëse do të
18 miratohej ky protokoll.

19 Lidhur me këtë do të them shkurtimisht që siç kemi thënë
20 shkurtimisht në parashtrimet tona me shkrim, të cilat i kemi
21 protokolluar me datë 15 dhjetor, kur kemi vërejtur se neni
22 40(2) lidhur me zhvillimin e procesit, ka të bëjë me -- ose më
23 saktë kërkon respektimin e plotë të të drejtave të akuzuarve
24 dhe gjithashtu respektimin edhe të të drejtave të
25 dëshmitarëve. Duhet të vendosi një drejtpeshim, sigurisht,

1 midis këtyre të dyjave. Kjo pasqyrohet tek rregulla 80. Së
2 pari barra i kërkon palës që kërkon masën që të justifikojnë
3 në secilin rast përse duhet miratuar masa mbrojtëse, dëshmitar
4 për dëshmitar. Pra rast pas rasti.

5 Së dyti masat mbrojtëse, kanë disa kushte të përcaktuara.
6 Kjo përputhet edhe me jurisprudencën ashtu sikurse edhe
7 përcaktohet edhe në shtojcën e vendimit në rastin Gucati dhe
8 Haradinaj të cilin Prokuroria pak a shumë e përdor si "copy-
9 paste" në propozimin e vet. Pala që kërkon masën mbrojtëse,
10 duhet që të bëjë të ditur me konkretësi rrethanat të cilat në
11 mënyrë objektive justifikojnë miratimin e këtyre masave. Siç
12 thuhet edhe në atë vendim. Prandaj pikë së pari duhet
13 identifikuar rreziku që kërkohet që të zvogëlohet përmes
14 masave të propozuara.

15 Dhe së fundi, kaloj tani në parashtrimet e ZPS-së:
16 drejtpeshimi midis të drejtave dhe këtu i kthehem nenit 40 dhe
17 rregullës 80 -- pra ky drejtpeshim duhet të jetë parimi tashmë
18 i konfirmuar që çdo masë e vendosur duhet të jetë më e pakta
19 kufizuese e domosdoshme për mbrojtjen e viktimave apo të
20 dëshmitarëve, siç është parë edhe në jurisprudencë.

21 Pra, i nderuar Gjykatës, mund të kalojmë tani te
22 parashtrimet e ZPS-së. Në protokollin fillestar nuk ka asnjë
23 orvatje për të justifikuar masat mbrojtëse, asgjë. Aty
24 përmendet në mënyrë të vagullt dinjiteti, siguria, mirëqenia e
25 dëshmitarëve. Këtë e kuptojmë të gjithë.

1 Por nuk ka asgjë që do të përmendej si rrezik. Përgjigjet
2 e Mbrojtjes së datës 15 dhjetor me hollësi i kanë kërkuar
3 Prokurorisë që të justifikojnë këto rreziqe. Mirëpo nuk kemi
4 marrë asnjë kundërpërgjigje gjatë këtyre dy muajve e gjysmë,
5 derisa i nderuar Gjykatës, kërkoi përgjigje ndaj parashtrimeve
6 të Zyrës Administrative.

7 Dhe më datë 14 shkurt është hera e parë që hasim këtë
8 frazë të re që është integriteti i dëshmisë apo i provave. Kjo
9 është diçka e cila është pjesë e rregullës 80. Diçka të cilën
10 ZPS-ja e parashtron për të justifikuar këtë kërkesë që ata
11 bëjnë. Një kërkesë në bazë rregullës 80.

12 Pra, i nderuar Gjykatës cilado qofshin akuzat që
13 pretendohet që ka bërë Mbrojtja, cilat do qofshin këto
14 pretendime, nuk janë një rrezik objektivisht i arsyetuar. Pra,
15 nuk përbëjnë asnjë përmbushje të kushteve të nevojshme për
16 masat ligjore që justifikojnë marrjen e këtyre masave
17 mbrojtëse.

18 Prandaj dhe duhet zbatuar rregulla 80.

19 Sa i takon pikës 2, pyetjes së dytë që ka bërë i nderuar
20 Gjykatës. Qëndrimi ynë është i tillë, që ne kemi të njëjtat
21 shqetësime të paraqitura nga mbrojtësit e z. Thaçi dhe z.
22 Veseli, kur kanë ngritur pikëpyetje, dyshime mbi absurditetin
23 e propozimit të këtyre masave që këto të zbatohen për të
24 gjithë dëshmitarët, përfshirë këtu diplomatë, gjeneralë, e
25 kështu me radhë. Pra edhe ne i kemi këto shqetësime në

1 përputhje me këto parashtrime.

2 Parashtrimi ynë është shumë i thjeshtë. Duhet kryer një
3 vlerësim i veçantë për rrezikun, për të justifikuar masat
4 përkatëse.

5 Për të qenë të qartë, i nderuar Gjykatës, ne nuk jemi
6 kundër asnjë ideje për masat mbrojtëse, ajo që kërkojmë ne
7 është që Rregullorja ka vite që është në fuqi. Këto rregulla
8 duhet të vazhdojnë të zbatohen edhe nga Prokuroria. Nëse
9 Prokuroria kërkon që të bëjë një kërkesë sipas rregullës 80,
10 ta bëjnë siç duhet. Kaq kërkojmë.

11 I nderuar Gjykatës, nëse kjo masë do të miratohet, ne ju
12 kërkojmë që kjo të jetë sa më pak kufizuese, për të mbrojtur -
13 që të sigurojë mbrojtjen e viktimave në fjalë.

14 Kalomë tani te pyetja e tretë. Ne i kemi të njëjta
15 qëndrimet me kolegët tanë. Sidomos sa i takon shkeljes së të
16 drejtave konkrete ndaj vetëfajësimit dhe të drejtës për të
17 përgatitur një pistë mbrojtjeje. Nuk kemi ndonjë gjë
18 thelbësore për të shtuar.

19 Por, kemi edhe një temë të vështirë përpara. Ne mendojmë
20 se protokollin i propozuar është i njëanshëm. Këto masa
21 kërkohen në mënyrë të njëanshme në kundërshtim me interesat e
22 Mbrojtjes. Kjo përbën shqetësim për ne dhe mendoj se duhet të
23 përbëjë shqetësim edhe për ju.

24 Sa i takon barazisë midis palëve, kolegu im z. Kehoe,
25 përdori fjalë të tjera, por unë i mbështes ato. Por unë kam

1 fjalë të tjera. Unë besoj se ky parim shumë qartë kërkon që
2 secila palë të ketë mundësi të barabarta për të paraqitur
3 provat e veta, në ato kushte që të mos të vendosen në pozita
4 të pafavorshme kundrejt kundërshtarit të tyre.

5 Ky është një formulim i thjeshtë. Por në fakt është shumë
6 i rëndësishëm. Si do të siguronim që nuk është shkelur barazia
7 midis palëve në një rast të caktuar. Rrethanat janë të
8 ndryshme në secilin rast, në secilën çështje gjyqësore. Palët
9 kanë burime të ndryshme, të cilat jo medoemos do të çonte në
10 një pabarazi. Por gjithsesi, është diçka e cila duhet mbajtur
11 parasysh për të parë nëse ka pasur shkelje të kësaj të drejte
12 konkrete.

13 Një gjë konkrete që mund të them, i nderuar Gjykatës,
14 është që ky propozim cenon vetëm njëërën anë dhe kjo në fakt
15 duhet të shërbejë si kambanë alarmi. Ne kemi parashtruar dhe
16 në parashtrimet tona të protokolluara të cilat i kemi
17 paraqitur me shkrim. Propozimi vendos në shënjestër vetëm
18 Mbrojtjen, thuajse vetëm Mbrojtjen.

19 Kini parasysh që Mbrojtja nuk ka asnjë detyrim që të
20 thërrasë këtu dëshmitarë. Nuk ka asnjë detyrim të tillë dhe
21 barra e provës i takon vetëm ZPS-së. Prokuroria në këtë rast
22 duket sikur nuk ka nevojë që të vërtetojë asgjë. Kjo
23 reflektohet në rregullën 104(5) e cila thotë se "Mbrojtja nëse
24 vendos që të paraqesë provat e veta" dhe kjo bën të ditur dhe
25 natyrën diskrecionare që ka kjo anë e procesit.

1 Sigurisht, sa i takon përdorimit të videoincizimit, unë
2 këtë do ta trajtoja më vete. Edhe nëse paraqiten prova nga
3 Mbrojtja, nuk do të kishte asnjëherë barazi në numrin e
4 dëshmitarëve. Nga ana e Prokurorisë kemi mbi 300 dëshmitarë.

5 Ndërkohë që ne tani kemi marrë dhe një informacion që
6 vetëm tani ne e kemi marrë dhe që na jep mundësinë që të
7 fillojmë vërtetë me hetimet tona.

8 Sa herë që e lexojmë këtë protokoll, sa herë që lexojmë
9 "pala thirrëse", të jemi realistë, "pala thirrëse" duhet të
10 ishte ZPS-ja. Pra duhet të merrni parasysh se që "pala
11 thirrëse" është ZPS-ja dhe "pala kundërshtare", sa herë që aty
12 thuhet në protokoll, nuk është gjë tjetër veçse "Mbrojtja".

13 I nderuar Gjykatës, përgjigja e Mbrojtjes më datë 14
14 shkurt 2022, e konfirmon këtë në mënyrë efektive dhe unë do
15 t'ju ofroj katër pika në mbështetje të kësaj.

16 ZPS-ja pretendon se të gjithë dëshmitarët kanë qenë nën
17 trysni për të vërtetuar patriotizmin e tyre. Por edhe këtu nuk
18 është se kanë dhënë ndonjë dëshmi apo provë për këtë.

19 Gjithashtu, ato përmendin në mënyrë të pabazuar "rreziqe
20 ndaj integritetit të provave dhe dëshmive përmes realizimit të
21 hetimeve të Mbrojtjes".

22 I nderuar Gjykatës, është qëndrimi i rishikuar në raundin
23 më të fundit të parashtrimeve që pjesa më e rëndësishme e
24 këtij protokollit është thjesht që ZPS-ja të jetë e pranishme
25 në të gjitha intervistat. Duhet të mbajmë parasysh lidhur me

1 këtë, kushtet të cilat i vendosur rregulla 80. ZPS-ja kërkon
2 një urdhër gjyqësor që të heqë të gjithë dëshmitarët nga
3 mundësia e Mbrojtjes dhe që t'i trajtojë të gjithë dëshmitarët
4 si zotërim i ZPS-së.

5 Së dyti, duke qenë se ata nuk po ndjekin procedurën e
6 vendosur tashmë për bërjen kërkesë për masa mbrojtëse, në këtë
7 rast, ato thjesht kërkojnë kompetenca diskresionare të
8 gjykatësit për këtë gjë.

9 Do kaloj edhe te pika e katërt, sepse është e shkurtër,
10 sa i takon intervistave të përbashkëta nga ekipet e Mbrojtjes.

11 Ne do të donim që ta bënim këtë. Synojmë ta bëjmë këtë në
12 të ardhmen. Por duam theksojmë se qëndrimi ynë është që këtë e
13 ka në dorë ekipet e Mbrojtjes.

14 Nuk duhet të na detyrojë kush që ta bëjmë në këtë mënyrë,
15 pra në mënyrë të përbashkët intervistat, sepse mund të ketë
16 kushte të cilat mund të na pengojmë që ta bëjmë një gjë të
17 tillë. Por nëse vendoset me rregull, pra me vendim nga
18 Gjykata, atëherë kjo do të pengonte edhe paraqitjen e provave
19 nga ne, pra mbledhjen e provave nga ana jonë. Plus që mund të
20 ketë edhe interesa të ndryshme sa i takon intervistimit të
21 këtyre dëshmitarëve.

22 Ne e kemi parasysh edhe faktin e ngritur që dëshmitarët
23 do të duhet që t'u nënshtrohen katër intervistave, por
24 gjithashtu mund të them edhe që nëse dëshmitari nuk do të
25 marrë pjesë në një intervistë, mjafton ta thotë edhe nuk e bën

1 intervistën.

2 Numri pesë nuk ka të bëjë me ne.

3 Numri gjashtë, sa intervistë takon qëndrimin të ekipeve
4 të Mbrojtjes, Mbrojtësit të Viktimave dhe Zyrës Administrative
5 lidhur me propozimet e përshtatura.

6 Sa i takon praninë së detyrueshme të ZPS-së në
7 intervistat që Mbrojtja do t'u bëjë dëshmitarëve, përbën
8 shqetësim për ne. Kjo mund do të kishte një ndikim shumë
9 frenues tek dëshmitarët. Mbase dëshmitari mund të ndihej, mund
10 të mendojë se duhet që të thotë pikërisht atë që i ka thënë
11 ZPS-së dhe mbase nuk mund t'i japë prova dhe dëshmi të tjera
12 Mbrojtjes. Ose mund të ketë frikë nga Prokuroria ose qoftë
13 edhe nëse mund të jenë persona të dyshuar. Por mund të ketë
14 edhe arsye të tjera pse ata mund të mos tregojnë dëshmi
15 shfajësuese, prova shfajësuese. Kjo është logjika e
16 parashtrimeve të ZPS-së mbi këtë temë.

17 Kemi edhe një qëndrim të fundit që duam të themi, sa i
18 takon videoincizimit të intervistave të dëshmitarët. Unë e
19 kuptoj që në fakt nuk është një pikë më vete në parashtrimet e
20 Zyrës Administrative.

21 Pra, aty përmendet si e përshtatshme dhe e domosdoshme.
22 Dua që t'ju rikujtoj i nderuar Gjykatës, që ky nuk është një
23 propozim që dëshmitarët të videoincizohen thjesht për hir të
24 transparencës. Thjesht është pra jo si një regjistrim i
25 thjeshtë, propozimi është që të videoincizohen këto intervista

1 të Mbrojtjes dhe pastaj palët të kenë të drejtë t'i
2 parashtrojnë këto si prova.

3 Pra shqetësimi ynë këtu do të ishte zbulimi i hetimeve të
4 Mbrojtjes dhe pistat e pyetjeve të cilat do t'i ndiqnim, do
5 t'i bënim në këto intervista. Por edhe sa i takon interesit të
6 të akuzuarve.

7 Por pikërisht për këtë, cila është lidhja midis mbrojtjes
8 së dëshmitarëve dhe përdorimit të këtyre videoincizimeve në
9 mbështetje të provave të Prokurorisë. Janë dy gjëra më vete.
10 Akuzat që i kanë ngritur Prokuroria tashmë, janë mbështetur
11 nga ZPS-ja. Përse do të donin që të shtinin në dorë edhe këto,
12 pikërisht për të mbështetur akuzat e ngritura tashmë?

13 Sa i takon modelit të ndjekur Gjykata Penale
14 Ndërkombëtare, mbështesim qëndrimin e ngritur nga kolegët që
15 përfaqësojnë z. Thaçi.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. Doni të thoni
17 që jeni kundër praktikës së GJPN-së?

18 Z. TULLY: [Përkthim] Po. Këtë nënkuptoj, i nderuar
19 Gjykatës.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë, pra keni të
21 njëjtin argument siç u parashtrua nga Mbrojtja e z. Thaçi.

22 Z. TULLY: [Përkthim] Po, atë thashë.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pra kjo do të thotë që
24 cenohet e drejta kundër vetëdiskriminimit dhe që duhet që të
25 jepen materialet, të nxirren materialet gjatë fazës hetimore.

1 Pra nuk duhen nxjerrë këto materiale. Këtë qëndrim keni edhe
2 juve?

3 Z. TULLY: [Përkthim] Po, e vërtetë, këtë qëndrim kemi dhe
4 ne.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po në sisteme të tjera të
6 së drejtës civile, ku Mbrojtja do të duhet që të japë, të
7 nxjerrë dokumentet dhe dëshmitë ndërkohë që, le të themi, që
8 dokumentacioni do të duhet të shqyrtohet nga të gjitha palët
9 në të njëjtën kohë. A e dini këtë pjesë këtë pjesë të
10 procedurës së gjykatave?

11 Z. TULLY: [Përkthim] Po e di i nderuar Gjykatës.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jo thjesht, domethënë nuk
13 është se dua të të fus në grackë, por problemi është që në
14 qoftë se ju thoni që është problem, i takon që është problem
15 për një numër të konsiderueshëm të vendeve evropiane. Këtë po
16 dua të them.

17 Z. TULLY: [Përkthim] I nderuar Gjykatës nuk jam në pozitë
18 dhe nuk është se dua që të fyej ndonjë nga sistemet, por
19 qëndrimi ynë është që ky është cenim i të drejtave të të
20 akuzuarit. Nuk dua të futem më tepër në detaje por ky është
21 qëndrimi i Mbrojtjes. Ne mendojmë që nxjerrja e
22 dokumentacioneve është shkelje e të drejtës e të akuzuarit.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

24 Tani le të kalojmë tek ekipi i fundit i Mbrojtjes.

25 Z. Baiesu ju lutem.

1 Z. BAIESU: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.

2 Ekipi i Mbrojtjes së Krasniqit mbështet dhe miraton
3 parashtrimet të cilat janë bërë nga ekipet e tjera të
4 Mbrojtjes në kundërshtim të protokollit.

5 Problemi kryesor që kemi identifikuar ne është që ZPS-ja
6 mundohet që të imponojë një protokoll gjithëpërfshirës, pa
7 asnjë përpjekje për të vërtetuar që ndonjë prej këtyre
8 dëshmitarëve apo të gjithë dëshmitarët janë vlerësuar në
9 rrethanat e tyre përkatëse dhe në qoftë se ata kanë nevojë për
10 protokollin mbrojtës apo jo, për masat mbrojtëse apo jo.

11 Në qoftë se një individ ka nevojë për masa mbrojtëse ZPS-
12 ja duhet të bëjë kërkesën por Gjykata nuk duhet që të japë
13 masa mbrojtëse për të gjithë dëshmitarët në këtë rast dhe
14 shumë prej tyre, si për shembull dëshmitarët ndërkombëtarë,
15 nuk kanë fare nevojë për një mbrojtje të tillë.

16 Sa i takon pikës së parë, identifikimit të bazës ligjore.
17 Ne mendojmë që baza ligjore është e rëndësishme të
18 identifikohet sepse rregulli 80 duhet të japë bazën për
19 imponimin ose vendosjen e masave mbrojtëse për rastet kur
20 përcaktohet standardi i nevojshëm. Pra me fjalë të tjera, nuk
21 duhet që të jepet baza ligjore për një protokoll
22 gjithëpërfshirës i cili zbatohet mbi të gjithë dëshmitarët.

23 Teksti i rregullës 80 e bën të qartë se masat mbrojtëse
24 duhet të jenë në pajtim me të drejtën e të akuzuarit, duhet që
25 të kërkohet pëlqimi i dëshmitarit përkatës dhe masat mbrojtëse

1 duhet të jetë përpjesëtimore me rrethanat e çështjes.

2 Që në Vendimin Kornizë për Nxjerrjen e Dokumenteve dhe
3 Dokumentet Lidhur me To, Gjykata e ka bërë të qartë që masat
4 mbrojtëse duhet të vlerësohen rast pas rasti. Që vlerësimi
5 duhet të realizohet për çdo kërkesë për masa mbrojtëse.

6 Problemi kryesor i këtij protokolli është që në mënyrë
7 efektive shmang vlerësimin e dëshmitarëve specifikë në qoftë
8 se ata kanë nevojë për masa mbrojtëse dhe kërkon që të
9 vendosen masat mbrojtëse për të gjithë dëshmitarët,
10 pavarësisht nga nevojat dhe demonstrimi i nevojës që kanë
11 dëshmitarët për vendosjen e masave të tilla. Edhe në
12 parashtrimet të Prokurorisë, pavarësisht në qoftë se
13 dëshmitari dëshiron apo jo të ketë mbrojtje, Prokuroria kërkon
14 mbrojtje gjithsesi të dëshmitarëve.

15 Ndërkohë që z. Ellis do të vazhdojë me pjesën tjetër të
16 pyetjeve tuaja.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Baiesu.

18 Z. Ellis, fjala për juve.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit i nderuar. Më lejoni të
20 filloj duke thënë këtë: Ne e kuptojmë plotësisht dhe e
21 mbështesim dëshirën për të mbështetur dinjitetin, privatësinë
22 dhe mirëqenien e dëshmitarëve në këtë çështje. Ne jemi të
23 vetëdijshëm për nevojën për të mos ritraumatizuar dëshmitarët
24 dhe ne nuk kemi asnjë qëllim për të vepruar në mënyrë të tillë
25 që do të cenonte dinjitetin, mirëqenien dhe integritetin e

1 dëshmitarëve në këtë çështje.

2 Prova më e mirë në mbështetje të këtij pozicioni është që
3 ne kemi pasur informacion, kemi dokumente të nxjerra sa i
4 takon dëshmitarëve dhe emrave, të dhënave të tyre, ndërkohë që
5 nxjerrja e dokumenteve ka ndodhur që në dhjetor të vitit që
6 shkoi dhe nuk kemi pasur asnjë ankesë sa i takon nxjerrjes së
7 këtij informacioni ndaj palëve të tjera.

8 Pyetja tjetër në axhendë është një pyetje e rëndësishme
9 dhe që është shtjelluar në parashtrimet tona dhe në qoftë se
10 shikohet kjo çështje, për shembull, në kornizën e rregullit 80
11 të Rregullore ose në kuadrin e të drejtave të njeriut. Dua të
12 them që çështja e proporcionalitetit është një çështje shumë e
13 rëndësishme këtu. Mbrojtja e dëshmitarëve duhet të sigurihet
14 për ata që kanë nevojë për këtë mbrojtje, por nuk duhet të
15 jepet për çdo dëshmitar edhe në ato rrethana kur nuk tregohet
16 se ekziston nevoja objektive e këtyre masave për dëshmitarët.

17 Dhe është natyra gjithëpërfshirëse e protokollit që
18 kërkon ZPS-ja që është dëshmi e tejkalimit të kompetencave të
19 ZPS-së. Nga 300 e ca dëshmitarë që janë pjesë e listës së
20 dëshmitarëve të ZPS-së, dëshmitarët janë me formime të
21 ndryshme, janë me pozicione të ndryshme dhe sigurisht që kanë
22 dëshmi të ndryshme sa i takon përmbajtjes së tyre. Një pjesë e
23 mirë e këtyre dëshmitarëve nuk kanë nevojë për zbatimin e
24 protokolleve që propozohen nga ZPS-ja.

25 Një shembull i qartë që u dha edhe nga kolegët e mi dhe

1 që dua ta theksoj edhe një herë është shembulli i dëshmitarëve
2 ndërkombëtare. Ndërkohë në listën e ZPS-së kemi më tepër se sa
3 30 dëshmitarë të cilët vijnë nga organizata ndërkombëtare, nga
4 shtete të ndryshme, nga OJQ, dëshmitarë ekspertë dhe këta janë
5 ndoshta llojet e dëshmitarëve me të cilët ne duhet të flasim.
6 Kështu që nuk e di se çfarë justifikimi do të kishte që të
7 vendoset një protokoll për të mos kontaktuar me këta
8 dëshmitarë.

9 Pra, në qoftë se do të flasim për shembull për një
10 dëshmitar që është një zyrtar i lartë, një ushtarak i lartë i
11 një shteti të caktuar, domethënë, a është serioze të thuhet që
12 atij do t'i cenohet dinjiteti dhe privatësia dhe mirëqenia e
13 këtij personi? Edhe pozicioni jonë sigurisht që është "jo".
14 Nuk ka si të jetë kështu. Dhe ky arsyetim zbatohet për një
15 numër të konsiderueshëm të dëshmitarëve në listë.

16 Kështu që mendojmë që përmes këtij shembulli ne kemi
17 demonstruar që protokollin nuk duhet që të zbatohet për çdo
18 dëshmitar në listën e dëshmitarëve të ZPS-së.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Përderisa po flisnim për
20 parimin e proporcionalitetit. A mund t'ju pyes z. Rees [sipas
21 përkthimit] se kush e vlerëson fushën e veprimit të
22 dëshmitarit që duhet të jetë pjesë e protokollit, duhet pra që
23 të përfitojë nga parashikimet e protokollit. A duhet që të
24 bëjmë një listë një listë tjetër të dëshmitarëve të cilëve ju
25 janë dhënë statusi i dëshmitarëve të mbrojtur apo duhet të

1 bëhet një lloj vlerësimi tjetër, mbështetur në parimin e
2 proporcionalitetit. Dhe në qoftë se "po" si duhet të bëhet.
3 Duhet të bëhet nga fillimi, domethënë për çdo dëshmitar duhet
4 të bëhet një vlerësim nga fillimi, sa i takon
5 proporcionalitetit? Këtë keni parasysh kur parashtruat këtë që
6 sapo na thatë?

7 Z. ELLIS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, shikoj dy mënyra
8 se si mund të realizohet kjo gjë.

9 Së pari, ose Prokuroria ose Avokati i Viktimave të bëjë
10 një kërkesë të re lidhur me masat mbrojtëse efektive që
11 kërkohen për dëshmitarët dhe në qoftë se këto masa
12 justifikohen me nevoja reale.

13 Dhe zgjidhja tjetër, mbase mund të jetë ajo çfarë mund të
14 arsyetohet nga pika dy në axhendë. Ndoshta që të përpiqemi që
15 të klasifikojmë apo t'i ndajmë dëshmitarët sipas kategorive.
16 Pra është parashtrimi i bërë nga z. Emmerson për z. Veseli dhe
17 ai ka planifikuar apo ka sugjeruar që një kategori të jenë
18 viktimat dëshmitarë.

19 Ndërkohë që preferenca ime do të ishte që të bëhej një
20 kërkesë e re për secilin prej dëshmitarëve mbështetur në
21 rrethanat specifike të secilit prej tyre. Duke u mbështetur
22 tek puna që është bërë deri tani, mendoj se një gjë e tillë
23 është e bëshme. Nuk është kaq e vështirë se ç'mund të duket në
24 pamje të parë.

25 Një tjetër shembull i dëshmitarëve që nuk duhet -- duhet

1 të përfitojnë nga protokolli janë ata dëshmitarë të cilët janë
2 marrë nga ish-anëtarë të UÇK-së. Janë individë të cilët kanë
3 dhënë dëshmi edhe në raste të tjera. Janë individë të cilët
4 nuk kanë shprehur fare problem lidhur me nxjerrjen e
5 identitetit të tyre për Mbrojtjen dhe në fakt identitetet e
6 tyre i kemi pasur në dorë prej shumë muajsh. Pra janë
7 gjithashtu edhe identitetet e dëshmitarëve të cilët janë të
8 identifikuar si të dyshuar nga ZPS-ja dhe ka shumë në fakt
9 dëshmitarë të kësaj kategorie të cilët në ushtrim të të
10 drejtave të tyre, kanë vendosur që të mos i japin përgjigje
11 Prokurorisë.

12 Kështu që, në qoftë se dëshmitarë të tillë japim pëlqimin
13 e tyre për t'u ulur me Mbrojtjen, atëherë nuk e di se pse
14 Prokuroria duhet patjetër që të jetë pjesë e intervistimit nga
15 ne. Pra, unë i zgjodha me kujdes fjalët kur thashë që, në
16 qoftë se këto dëshmitarë duan që të flasin me Mbrojtjen. Dhe
17 dua të them, dua ta nënvizoj edhe një herë, rëndësinë e fjalës
18 "pëlqim". Unë nuk kam asnjë kompetencë që ta detyroj dikë që
19 të flasë me mua. Domethënë duhet me patjetër dëshmitari të
20 japë pëlqimin e tij, që të intervistohet prej nesh. Dhe çdo
21 gjë në kuadrin e Mbrojtjes mbështetet tek "pëlqimi".

22 Sa i takon viktimave dëshmitarë, jam dakord me
23 parashtrimin që është bërë se "kur dëshmitarët përfaqësohen
24 nga mbrojtja e avokatëve, atëherë duhet që të futet në lojë
25 neni 16 i Kodit të Sjelljes". Pra duhet, është e detyrueshme

1 që të respektojmë parashikimet e Kodit të Sjelljes dhe duhet
2 z. Laws të vihet në kontakt dhe të informohet për zhvillime të
3 tjera. Megjithatë, në rastin në fjalë do të duhet që të dimë
4 se cilat janë viktimat dëshmitarë në mënyrë që të mund të
5 lehtësojmë këtë lloj sjelljeje.

6 Jam i shqetësuar për parashtrimet që ka bërë Prokuroria
7 në propozimin e rishikuar të vet, që Prokuroria duhet të jetë
8 gjatë të gjithë kohës e pranishme në intervistat me
9 dëshmitarët, pavarësisht nga fakti në qoftë se dëshmitari e do
10 Prokurorinë të jetë e pranishme apo jo. Pra logjika e
11 parashtrimit 693 duket sikur është që mbase mund të ketë
12 dëshmitarë të caktuar të cilët mund të ndihen jo rehat po të
13 kenë dhe ZPS-në të pranishëm.

14 Por nga ana tjetër çfarë ndodh me atë dëshmitarë të cilët
15 thonë që duan që të intervistohen pa praninë e ZPS-së. Pra ata
16 duan që intervista të zhvillohet pa praninë e ZPS-së. Kështu
17 që për këtë arsye protokolli nuk ka pse të jetë
18 gjithëpërfshirës për të gjithë kategoritë dhe llojet e
19 dëshmitarëve.

20 Pra, kaq kisha për të thënë i nderuar Gjykatës për pikën
21 e dytë të axhendës. Tani le të kalojmë tek pika e tretë. Për
22 pikën e tretë do t'ia lë fjalën kolegut tim.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

24 Ju lutem vijoni.

25 Z. BAIESU: [Përkthim] Jemi plotësisht në mbështetje për

1 pikën, për gjykimin e drejtë parashtrimet e Mbrojtjeve të
2 tjera.

3 Dhe dua të them që të kërkosh që ZPS-ja të jetë e
4 pranishme në të gjitha intervistat e dëshmitarëve nuk është
5 asgjë tjetër veçse një rrugë e shkurtër që ZPS-ja të mund të
6 ketë qasje në dokumente ose informacione të tjera inkrinuuese
7 në të cilat ZPS-ja nuk do të kishte qasje ose ndoshta do të
8 kishte qasje më tej, më vonë në proces gjyqësor.

9 Siç u tha sot, detyrimet për nxjerrjen, sipas Rregullores
10 janë josimetrike. Mbrojtja ka të drejtën që të japë dokumente,
11 të nxjerrë dokumente sipas rregullës 104(5) dhe ndërkohë
12 dokumentet ZPS-së mund t'ia japë deri në 15 ditë përpara se sa
13 të hapet çështja dhe vetëm për ato dokumente të cilat do të
14 përdoren në Gjykatë, mund t'ia japë ZPS-së.

15 Sa i takon pyetjes tjetër, pikës 4. Mbrojtja e Krasniqit
16 është e hapur për intervistat e përbashkëta me ekipet e tjera
17 të Mbrojtjes. Megjithatë, ato ka të ngjarë që mund të ketë për
18 shembull përparësi të ndryshme ndërmjet ekipeve të Mbrojtjes
19 dhe mundet që për arsye objektive, domethënë të kemi burime të
20 kufizuara sa i takon realizimit të pyetjeve të përbashkëta.

21 Tani kalojmë te pika 6. Ndërkohë kolegët e mi do të japin
22 parashtrimet edhe është më mirë që të fillojmë me pikën 6, në
23 mënyrë që të mos ndërpres fjalën time dhe pastaj t'ia jap
24 fjalën kolegut tim.

25 Sa i takon pikës 6, kundërshtimi thelbësor për ZPS-në nuk

1 është një kundërshtim i thjeshtë, por është një kundërshtim i
2 cili ka të bëjë me materialitetin dhe me mosbërjen e ndonjë
3 ndalimi dallimi ndërmjet dëshmitarëve, të cilët kanë nevojë
4 për mbrojtje dhe dëshmitarët të cilët nuk kanë nevojë për
5 mbrojtje. Dhe për këtë arsye ZPS-ja do të duhet që të dëshmojë
6 në qoftë se kjo kërkesë e tyre është e mbështetur apo jo. Në
7 të kundërtën në qoftë se nuk trajtohet kjo çështje, atëherë do
8 të kemi të bëjmë me një situatë kur cenohet e drejta e të
9 akuzuarit.

10 Nuk jemi fare dakord me ZPS-në, me qasjen e saj që kërkon
11 praninë e saj në të gjitha intervistat dhe atëherë kur
12 dëshmitari nuk dëshiron që ZPS-ja të jetë e pranishme. Në
13 qoftë se dëshmitari ka diçka që do që të ndajë me Mbrojtjen
14 dhe nuk dëshiron që ZPS-ja të jetë e pranishme, atëherë nuk
15 është e nevojshme që të jetë e pranishme ZPS-ja sepse në të
16 kundërtën do të ketë ndikim mbi dëshmitari, por gjithashtu
17 edhe në rezultatin e procesit të hetimit.

18 Le të mendojmë në qoftë se dëshmitari dëshiron që të
19 flasë me Mbrojtjen për mënyrën se si e ka kryer intervistimin
20 ZPS-ja. Është e qartë që në një situatë të tillë dëshmitari
21 nuk mund të flasë lirshëm në qoftë se është prokurori i
22 pranishëm në marrjen në pyetje prej nesh.

23 Tani më lejoni t'i jap sërish fjalën z. Ellis që të
24 trajtojë pikat e tjera të axhendës.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Baiesu.

1 Z. Ellis, dhe jemi pranë 15 minutëshit në dispozicion.

2 Kështu që kini parasysh kohën ju lutem.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Në këtë rast,
4 do të kaloj shkurtimisht temat të cilat nuk u cekën nga kolegu
5 im. Pika 5.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Ellis, ju dëgjojmë keq.

7 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Atëherë sa i
8 takon pikës 5, e trajtuam. Kështu që do të kaloj te pika 7.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju dëgjuam keq. Ju lutem
10 thuajeni edhe një herë atë çfarë thatë dhe shpresojmë që t'ju
11 dëgjojmë pak më mirë kësaj radhe.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Ju kërkoj
13 ndjesë, i nderuar Gjykatës, nuk e di në qoftë se më dëgjoni
14 pak më mirë tani?

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jo. Nuk është fare e qartë.
16 Kështu që sugjeroj që në qoftë se nuk e keni problem të fikni
17 mikrofonin dhe ta ndizni përsëri ose ndoshta të fikni videon
18 sepse mund të ndihmojë në cilësinë e audios dhe të dëgjoheni
19 më mirë këtu në sallë.

20 Ndërkohë që tani nuk ju dëgjojmë fare z. Ellis. Dhe
21 imazhi ka ngirë në Zoom.

22 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po mundohem që
23 të fik videon. Nuk e di më dëgjoni?

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani ju dëgjojmë.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I nderuar

1 Gjykatës, ju kërkoj ndjesë për problemin.

2 Pra fillova duke thënë që pika 5 i drejtohet Zyrës
3 Administrative, kështu që do ta kaloj shpejt.

4 Megjithatë duhet të them diçka lidhur me pikën 7, në
5 kohën që kam në dispozicion.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju lutem vijoni.

7 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit,
8 i nderuar Gjykatës.

9 Pozicioni ynë në përgjithësi është që ka rrezik që të
10 zbatohen modele që rrjedhin nga gjykata të tjera në mënyrë të
11 drejtpërdrejtë në DHSK sepse gjykata të ndryshme i kanë bërë
12 përzgjedhjet e tyre mbështetur në rregulloret dhe rrethanat e
13 tyre dhe sipas çështjeve që kanë trajtuar.

14 Në veçanti lidhur me GJPN-në për shkak të faktit që
15 statutet dhe rregullorja e GJPN-në janë të ndryshme nga
16 statuti dhe rregulloret dhe dispozitat e DHSK-së dhe nga
17 natyra është e rëndësishme që të thuhet që GJPN-ja thotë që
18 është detyrim që të bashkëpunohet me të gjitha vendet,
19 ndërkohë që Dhomat e Specializuara të Kosovës funksionojnë
20 vetëm për Kosovën.

21 Është një gjykatë e cila është krijuar mbi kuadrin ligjor
22 të Kosovës. Kështu që sa i takon kompetencës ose për shembull
23 institucionit të Kosovë, këto institucione, për shembull
24 polica e Kosovës, mendohet të jetë bashkëpunese me të. Dhe ja
25 vlen që të thuhet që përmasa e kësaj çështjeje e bën atë të

1 dallueshme, të ndryshme nga çështje të cilat janë zgjedhur,
2 janë trajtuar më parë nga GJPN-ja. Për shembull rasti Bemba ka
3 përfshirë 42 dëshmitarë të Prokurorisë -- 82 dëshmitarë të
4 Prokurorisë, megjithatë domethënë asnjë rast tjetër nuk kemi
5 parë një çështje ku janë përfshirë kaq shumë dëshmitarë 326
6 dëshmitarë siç parashikon ZPS-ja. Pra duhet që të gjehet një
7 procedurë e cila funksionon me të akuzuarit. Se nuk është e
8 thënë që një procedurë që ka funksionuar në një gjykatë
9 tjetër, për shembull në një gjykatë në një çështje që ka pasur
10 katër të akuzuar, nuk mund të thuhet që është e aplikueshme
11 dhe mund të jetë e frytshme në kuadrin e çështjes që po
12 diskutojnë Dhomat e Specializuara të Kosovës.

13 Për momentin nuk është se kam ndonjë protokoll në mendje
14 sa i takon Gjykatës Libanit. Domethënë çfarë protokolli përdor
15 Gjykata e Libanit. Megjithatë, sa i takon TPNJ-së që është më
16 e afërta sa i takon fushës së veprimit dhe jurisprudencës edhe
17 në këtë rast, përfshirë çështje që janë cituar nga ZPS-ja, në
18 përgjithësi ka njohur të drejtën e kontaktimit të palës tjetër
19 për sa i takon dëshmitarëve dhe të kërkohen masa mbrojtëse për
20 dëshmitarë të caktuar.

21 Për shembull, në qoftë se do t'ju sillnim në vëmendjen
22 tuaj vendimin e Karaxhiçit me datën 8 nëntor 2012, z. Tieger
23 ka qenë drejtuesi i Prokurorisë për atë rast dhe besoj se
24 është një çështje që e mbajnë pjesa më e madhe prej nesh dhe
25 Prokuroria në pozicionin e saj në çështje në fjalë tha që nuk

1 kishte interes vetjak për dëshmitarët dhe si rezultat
2 pozicioni i mbajtur ishte tërësisht i ndryshëm nga ajo çfarë
3 propozohet që të bëhet në kuadrin e protokollit të ZPS-së.

4 Ne, absolutisht të njëjtën gjë po kërkojmë që të zbatohet
5 këtu. Pra ne kërkojmë që të ekzistojë e drejta e përgjithshme
6 për të intervistuar dëshmitarët e palës tjetër. Sigurisht në
7 varësi të mundësisë për të kërkuar masa mbrojtëse, në qoftë se
8 këto masa mbrojtëse do të jenë të justifikuar në rastin
9 konkret.

10 Sa i takon pikës 8, nuk është se kemi ndonjë kundërshtim.
11 Jemi të gatshëm që të përfshihemi në diskutime *inter partes*.
12 Megjithatë, në qoftë se pozicioni i Prokurorisë vazhdon që të
13 mbetet që protokollin të zbatohet mbi të gjithë dëshmitarët,
14 nuk mendoj se do të shkojmë shumë larg.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

16 Tani të kalojmë tek Zyra Administrative.

17 Z. Nilsson, a mund t'ju përgjigjeni këtyre pyetjeve,
18 sipas radhës dhe nëse doni të përditësoni parashtrimet tuaja
19 pas përgjigjes së Prokurorisë lidhur me ndikimin në buxhet dhe
20 organizim.

21 Keni fjalën.

22 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit.

23 Po, do të përqendrohesh në pyetja 5 dhe 6 që na
24 drejtohen në Zyrë Administrative. Nuk kemi parashtrime për
25 çështjet e tjera.

1 Po e filloj pra me pyetjen e pestë që ka të bëjë me
2 faktin nëse Zyra Administrative mund të japë informacion më
3 konkret lidhur përfshirjen e saj, pra pasoja që ka ky propozim
4 për punën e saj. Lidhur këtë çështje po e lë mënjanë
5 propozimin e rishikuar të Prokurorisë. Do t'i kthehem më pas.

6 Kemi marrë disa indikacione, të paktën nga disa prej
7 ekipeve të Mbrojtjes për numrin e dëshmitarëve që do të
8 intervistojnë edhe për çështje të tjera që i kemi vënë në
9 dukje në parashtrimet tona lidhur me numrin e intervistave, ku
10 do të zhvillohen ato, kohëzgjatjen e tyre e kështu me radhë.

11 Për sa i takon këtyre pyetjeve, Mbrojtja nuk na ka dhënë
12 shumë gjëra konkrete dhe është e kuptueshme është vështirë t'u
13 përgjigjesh këtyre pyetjeve në mënyrë abstrakte. Megjithatë i
14 jemi mirënjohës predikacionit që na kanë dhënë sepse na e kanë
15 bërë disi më konkrete atë që na pret, atë që duhet të bëjmë ne
16 dhe ju si Trup Gjykses.

17 Nga perspektiva e Zyrës Administrative mund të them se ne
18 na duhet të kemi informacion mjaft preciz, të saktë, pra që të
19 planifikojmë këto intervista dhe të menaxhojmë burimet
20 ekzistuese dhe të kërkojmë burime shtesë, në rast nevojë. Për
21 fat të keq nuk e kemi një informacion kaq të saktë për
22 momentin.

23 Kështu që, nëse Zyra Administrative do të udhëzohet të
24 veprojë siç ishte parashikuar në protokollin fillestar, duhet
25 të ulemi me palët dhe të diskutojmë, të konsultohemi për të

1 gjetur rrugën më të mirë dhe pastaj do të hartojmë një plan
2 për misionet e mundshme. Dhe vetëm në këtë kontekst konkret
3 mund të bëhet një vlerësim i mundësisë të realizimit të këtyre
4 çështjeve. Pra, çështja nuk shtrohej shumë se "sa mund të
5 ndihmojë", por "si mund të ndihmojmë".

6 Kaq mund të them për momentin me informacionin që kemi
7 përpara sot për sot.

8 Të kaloj tek pyetja 6. Këtu vërejmë se propozimi i
9 rishikuar parashikon një rol shumë më të kufizuar të Zyrës
10 Administrative. Kryesisht protokollin e rishikuar parashikon
11 një organizim sipas të cilit Zyra Administrative mund të
12 përfshihet në disa intervista në rrethana të jashtëzakonshme
13 dhe vetëm sipas vendimit tuaj apo të Trupit Gjykses. Do të
14 thoja që fushëveprimi dhe roli i saktë i Zyrës Administrative
15 në këto rrethana do të varej nga kërkesa e palës thirrëse, apo
16 e çdo pale dhe së fundi pastaj në bazë të vendimit të marrë.

17 Shumë shkurt. Një organizim i tillë, siç është
18 parashikuar në protokollin e rishikuar mund dhe sigurisht do
19 të plotësohet nga Zyra Administrative. E vetmja gjë që
20 kërkojmë të merret parasysh është që të na jepet një njoftim
21 në periudhë të mjaftueshme për t'u siguruar që të jemi në
22 gjendje dhe të ofrojmë shërbimet tona në kohën e duhur dhe në
23 mënyrën efikase. Besoj kaq mund të them, he për he, për këtë
24 pyetje.

25 Për sa i takon mbase pyetjes së fundit që keni bërë, nuk

1 e di ku jemi lidhur me diskutimet e mundshme midis palëve.
2 Nëse do të ndodhin, ne jemi të gatshëm të marrim pjesë apo do
3 të jemi të disponueshëm për konsultime në rast se do të
4 nevojitemi apo duke e ditur që roli ynë do të jetë i kufizuar.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Nilssen.

6 Tani ja jap fjalën Prokurorisë.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Përpara se
8 të përgjigjet Prokurori, dua të flas për nja dy minuta.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do t'ia jap së pari
10 Prokurorisë fjalën pastaj do t'ju pyes edhe një herë për të
11 folur nëse keni.

12 Z. Prokuror. Dhe vetëm për atë që u tha nga Mbrojtja. Jo
13 argumente të reja. Sepse do ta përbyllim tani.

14 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
15 Gjykatës.

16 Së pari, dy çështje ligjore, shkurtimisht. Në përgjigje
17 të Mbrojtjes, neni 21(iii) i Statutit të Romës kërkon që
18 zbatimi i ligjit përpara GJEDNJ-së të përputhem me mbrojtjen e
19 të drejtave të njeriut dhe fakti që...

20 Pra këto pretendime për shkeljen e të drejtën e njeriut
21 janë hedhur poshtë gjithmonë që nga viti 1999 dhe e kam fjalën
22 paragrafin 323 deri në 327.

23 Disa ekipe të Mbrojtjes kanë parashtruar se nuk ekziston
24 klima e frikësimit në Kosovë dhe asgjë nuk mund të jetë më
25 larg të vërtetës. Ka pasur prova të konsiderueshme për këtë

1 pikë lidhur paraburgimin. Ka një histori të çështjes në Kosovë
2 dhe TPNJ ku ka ndodhur kjo dhe kjo Gjykatë është ngritur duke
3 pasur parasysh këtë histori të mirënjohur.

4 Në fakt, situata është kaq e rëndë sa që ZPS-ja nuk ka
5 mundur të sigurojë bashkëpunimin e një eksperti ndërkombëtar
6 dhe dëshmitarëve ndërkombëtarë, shprehimisht për shkak të
7 shqetësimeve të sigurisë të lidhur me këtë klimë në Kosovë.
8 Dhe këta janë dëshmitarë ndërkombëtarë.

9 Më parë i kemi dhënë Gjykatës shembuj konkretë të
10 shqetësimeve të tilla të sigurisë dhe të frikësimit të ndjerë
11 nga dëshmitarët ndërkombëtarë. Dhe e kam fjalën për
12 parashtrimin F5, Shtojcën 1, paragrafin 6 dhe 7. Për shumë nga
13 dëshmitarët e tjerë ndërkombëtarë, vetë ZPS-së i është dashur
14 t'u përmbahet miratimeve të rrepta dhe kërkesave të tjera për
15 të mundur të flasë me këta dëshmitarë.

16 Lidhur me dëshmitarët në Kosovë, këto shqetësime janë
17 edhe më të forta. Ka një realitet dhe një Rregullore këtu, por
18 ka dhe një realitet dhe Rregullore në Kosovë dhe një realitet
19 në Kosovë i cili përbën shumë trysni për dëshmitarët kur nuk
20 kanë zgjedhje, kur u drejtohet Mbrojtja dhe u kërkohet të
21 bëjnë atë që duhet të bëjnë. Dhe Mbrojtja e Thaçit aktivisht
22 po e nxit një klimë të tillë duke pretenduar se kjo është një
23 çështje kundër UÇK-së. Kjo nuk është e vërtetë. ZPS-ja e ka
24 bërë të qartë se nuk ka asnjë çështje kundër UÇK-së. Mbrojtja
25 e Thaçit qëllimisht e shtrembëron të vërtetën lidhur me

1 natyrën e kësaj çështje për të shtuar trysninë ndaj
2 dëshmitarëve. Duke theksuar hapur se do të vazhdojë ta bëjë
3 pikërisht këtë gjë.

4 Të jemi të qartë. Protokolli i propozuar nuk ka për
5 qëllim që të mbrojë sjelljen e keqe nga ana e mbrojtjes. Ai i
6 jep mundësi të gjitha palëve të bashkëpunojnë të mbrojnë
7 integritetin e provave dhe shpejtësinë e procedurave.

8 Por ne duhet të pranojmë realitetin këtu. Ne e shohim se
9 realiteti në Kosovë dhe këtë e shikojmë edhe në këtë sallë
10 gjyqi dhe pjesë e këtij realiteti për shembull është publikimi
11 në Bota Sot, në 3 nëntor 2021 dhe ai raport i botuar aty,
12 përfshin se disa anëtarë të shërbimit inteligjent të Kosovës
13 po jua ofrojnë shërbimet ekipit të Mbrojtjes së Thaçit. Një
14 prej tyre i përmendur në atë artikull është një ish-anëtar i
15 KIA-s për abuzimin e pushtetit të tij edhe në shtyp se është
16 përfshirë si në përpjekjes e KIA-s për të marrë informacion
17 lidhur me zyrën e Presidentit të Kosovës dhe për të organizuar
18 dëshmi të rreme të dëshmitarëve nga agjentë të KIA-s në një
19 gjyq në Kosovë.

20 Sigurisht ne nuk e dimë historinë e vërtetë, të gjithë
21 historinë e vërtetë. ZPS-ja nuk e di se kush punon
22 drejtpërdrejt apo tërthorazi për ekipin e Thaçit. Por ne e
23 dimë se Kodi i Sjelljes vlen vetëm për mbrojtësit dhe jo për
24 ekipet e tyre në plan më të përgjithshëm. Kështu që kur vjen
25 puna tek individë të angazhuar si hetues nga Mbrojtja kjo nuk

1 vlen. E dimë gjithashtu se kjo Gjykatë nuk mund të injorojë të
2 kaluarën dhe informacionet e vërteta në të tashmë dhe duhet të
3 veprojë në bazë të tyre.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

5 Përpara se t'ia jap fjalën Mbrojtjes, i kërkoj z. Laws.
6 Po e pyes: Z. Laws, keni ndonjë gjë që doni të shtoni? Dhe një
7 pyetje shtesë që kam për ju. A keni ndonjë qëndrim lidhur me
8 propozimin e përditësuar të ZPS-së që Zyra Administrative të
9 luajë një rol më të kufizuar lidhur me propozimin fillestar.

10 Z. LAWS: [Përkthim] Mendova se e trajtoja në parashtrimet
11 e mia. Por nëse jo, atëherë të them "jo" nuk kemi asnjë
12 kundërshtim lidhur me kufizimin e rolit të Zyrës
13 Administrative me kusht që, siç sugjeruam t'i nënshtrohet
14 rrethanave përjashtimore.

15 Shumë shkurt doja të thoja këtë: Protokolli i Gjykatës
16 Ndërkombëtare Penale i zbaton rregullat e veta për të gjithë
17 dëshmitarët. Arsyeja për këtë është se siç e tha ZPS-ja, e
18 theksoj, ka një numër faktorësh të ndryshëm që përbëjnë atë
19 protokoll që mund të mundësojnë menaxhimin e një numri të madh
20 apo të vogël dëshmitarët. Për shembull regjistrimet në video.

21 Është e arsyeshme që të ketë një zgjidhje që të plotësojë
22 të gjithë kategoritë e dëshmitarëve. Po të shohim
23 alternativat, e kuptojmë se pse GJPN-ja iu përmbajt këtij
24 protokolli.

25 Në të kundërt, siç propozohet për shembull nga z. Ellis,

1 mund të bëhen kërkesa për intervistën që të justifikojnë
2 praninë e ZPS-së apo regjistrimin. Po të bëhet kështu, nuk ka
3 për të përfunduar kurrë. Do të jetë një recetë për qëndrim në
4 vend, për mosecurinë e procesit, sepse po të kemi 150
5 dëshmitarë do të ketë 150 vendime, 150 kërkesa, 150
6 intervista.

7 Pra kur të kërkohen dëshmi për të vërtetuar atë që thuhet
8 për çdo individ, ne parashtrojmë me respekt, diçka që do të
9 krijojë vështirësi. Nuk po e them më fort se kaq. Ne kemi
10 interes për dëshmitarë përtej atyre që përfaqësojmë
11 drejtpërdrejtë. Dhe kur thashë më herët, lidhur me atë që tha
12 z. Emmerson, kemi interes për gjysmën e dëshmitarëve lidhur me
13 mundësinë e zhvillimit të këtyre procedurave. Sepse viktimat
14 pjesëmarrëse kanë interes për zhvillimin e këtyre procedurave
15 në tërësi.

16 Dhe këtu bëhet fjalë për një propozim që do të përfundojë
17 në mosqenien reale, të mundshme të këtyre procedurave.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kehoe.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni, doja të bëja
20 një koment, nëse kam kohë.

21 Besoj që ju i nderuar Gjykatës, e shikoni se çfarë do të
22 bëjë Prokuroria duke theksuar një klimë frikësimi pa prova. Të
23 njëjtën gjë e bën edhe në rastin e policisë së Kosovës, kur
24 erdhi puna te kërkesa për paraburgimin. Ato thanë atë që unë
25 do ta quaja budallallëk, pa e bazuar gjëkund.

1 Ata të njëjtën gjë po e bëjnë edhe këtu tani. Po i
2 kërkojnë kësaj Gjykate, t'u japë atyre atë që kërkojnë sepse
3 thonë që "ekziston një klimë frikësimi". Kush është frikësuar?
4 Kanë 326 dëshmitarë, 157 dëshmitarë të mbrojtur. Cili prej
5 këtyre 157 dëshmitarëve të mbrojtur është frikësuar? Po të
6 tjerët, emrat e të cilëve janë listuar aty? Z. McCloskey i ka
7 intervistuar. Po ata janë frikësuar? A ka ndonjë provë, cilado
8 qoftë ajo?

9 Por, të dëgjojmë këtë budallallëk të paraqitur përpara
10 jush si për të thënë, "sikur po ju them që është një paradë e
11 tmerrshme" dhe "ne duhet të paraqitemi përpara çdo interviste
12 që bën Mbrojtja" dhe "ne duhet të jemi përpara aty" dhe
13 dëshmitari nuk mund të heqë dot dorë nga jo. Është një diçka
14 që paraqitet nën maskën e klimës së frikësimit.

15 Ekspertë ndërkombëtarë që nuk ka mundur ZPS-ja t'i marrë
16 për të paraqitur dëshmi, mos është kërcënuar vallë? Mos e kanë
17 këshilluar njeri që të mos e bëjë këtë? Apo mos do të dëmtohej
18 personalisht ai apo të dashurit e vet? Sigurisht që jo.

19 Problemi, Gjykatës, këtu është që ajo që ata po ju
20 paraqesin është klima e frikës për qëllimet e tyre, për të
21 keqen e klientit tim dhe të të akuzuarve të tjerë, të cilët
22 kanë të drejtë të flasin me këta dëshmitarë, jashtë pranisë së
23 ZPS-së, e cila më besoni, do të sjelli frikën e tyre dhe
24 frikësimin e tyre aty.

25 Për shembull, individi që u thirr dhe i tha që do të jetë

1 i dyshuar dhe nuk është akuzuar, por i thanë që do të jetë i
2 dyshuar. Dhe ka shumë dëshmitarë të tillë, të frikësuar nga
3 Prokuroria, sigurisht që u frikësuan, nuk donin të
4 akuzoheshin. Nuk donin që t'ju ngriheshin akuza ndaj tyre. A
5 ishte dëshmia pjesë e këtyre intervistave? Sigurisht që jo.
6 Mbrojtja u thirr në këto intervista? Jo. Asnjëherë.

7 Dhe e gjithë ideja e paraqitur nga Prokuroria se këta
8 dëshmitarë nuk kanë zgjedhje, unë lexova një transkript dje -
9 dje - jo më larg se dje, ku një dëshmitar dhe mund t'jua them
10 se kush ishte ai dëshmitar në seancë të mbyllur, nëse është
11 nevoja, refuzoi të dëshmonte dhe përdori të drejtat e tij.

12 Përse nuk u frikësua ai prej kësaj, nuk u tremb ai? Përse
13 nuk u përfshi ai në këtë klimë frikësimi, sa të mos fliste me
14 Prokurorinë. Ai u soll këtu për një intervistë si i dyshuar.

15 Pra nuk paska zgjedhje të vërtetë? Prokuroria duhet t'i
16 shikojë ato qindra dëshmitarë të vet, jo vetëm ata që kanë
17 listuar por edhe ata që na kanë sjellë ne dhe të gjithë ata
18 dëshmitarë, që për çfarëdo arsyeje nuk pranojnë të japim
19 dëshmi, për gjëra që s'kanë fare të bëjnë me Presidentin Thaçi
20 dhe me të akuzuarit e tjerë.

21 Ata po përpiqen që këtë Gjykatën ta mbysin me frikë të
22 bazuar të asgjë. Kjo aktakuzë pret që nga nëntori 2020 dhe
23 Prokuroria nuk ka dalë me ndonjë dëshmitar, nga qindra
24 dëshmitarë që të thotë se është frikësuar. Sigurisht askush
25 nuk mund të hedhi ndonjë dyshim në këtë dhomë, por megjithatë

1 ata vijnë këtu dhe hedhin kartën e frikës përpara Gjykatës dhe
2 ju thonë që duhet ta bëni këtë gjë që propozojnë, për të keqen
3 e të këtyre të akuzuarve.

4 Gjykata të tjera kanë me protokolle të tillë, por asgjë,
5 as larg nuk krahasohet me këtë protokoll, apo me një situatë
6 ku një intervistë të kryhet në prani të ZPS-së, të
7 regjistrohet dhe pastaj ata ta përdorin si provë kur të
8 paraqesin çështjen e tyre.

9 Si nuk qenka kjo shkelje e rregullës 104(5)? Ne mund të
10 flasim për protokolle të tjera, TPNJ, GJPNJ e të tjera, por
11 duhet të udhëhiqemi nga Rregullorja që na ka vënë përpara
12 Dhomat e Specializuara dhe rregulla 104(5) është ajo që ne
13 duhet të ndjekim.

14 Dhe duke pasur parasysh gjithë atë që do të bëjë
15 Prokuroria, siç thashë, është që ata të kontrollojnë mënyrën
16 se si Mbrojtja zhvillon hetimet e veta, se kush thotë çfarë,
17 kush bën pyetje çfarë dëshmitarëve. Duan të mësojnë për
18 informacione shfajësuese që mund të vijnë nga këta dëshmitarë,
19 që Mbrojtja ka autoritetin për t'i nxjerrë. Duan të
20 kontrollojnë gjithçka. Kini parasysh se kanë 157 dëshmitarë të
21 mbrojtur dhe 103 të tjerë për të kontrolluar të gjithë këtë
22 procedurë t'ua marrin kontrollin juve, i nderuar Gjykatës.

23 Po të lëmë mënjanë atë që ata kanë parashtruar. Të flasim
24 për aspektet praktike të kësaj që ata thonë. Kanë 326
25 dëshmitarë. Sapo dëgjova nga z. Ellis, se ai e dëgjoi 265 që

1 janë thirrur. Unë mund t'ju them se intervistat e këtyre
2 personave do të ishin të themi më shumë se 100. Nuk ta them
3 dot me saktësi, me gjithë respektin në këtë çast se sa do të
4 jenë, por janë mbi 100 dëshmitarë.

5 100 dëshmitarë për t'i koordinuar, për t'i sjellë këtu me
6 regjimin e tyre, ZPS-ja të jetë aty -- ky gjyq në këtë mënyrë
7 nuk do të arrijë të fillojë as në 2024-n. Thjesht zotimi i
8 ZPS-së që e ka paraqitur është i pamenaxhueshëm. Dhe askush,
9 sigurisht jo ZPS-ja, nuk e ka përfshirë këtë aspekt në atë që
10 i propozojnë Gjykatës për ta lidhur me protokollin.

11 Siç tha kolegu im, në qoftë se bëhet fjalë për një
12 dëshmitar delikat që është shumë i dëmtuar, kryesisht
13 mendërisht, askush në këtë dhomë nuk është i interesuar të
14 dëmtojë njeri. Duam të bëjmë atë që është e nevojshme për të
15 mbrojtur klientët tanë. Por nuk duam t'i bëjmë keq, apo t'i
16 shkaktojmë vuajtje askush. Edhe një herë siç thanë kolegët,
17 duhet të ketë një ekuilibër, një balancë. Kush i do këta
18 dëshmitarë, cilat janë ata, cilat janë problemet konkrete. Dhe
19 ne mund të punojmë pastaj në bazë të këtyre. Por nuk kemi
20 asgjë, kemi vetëm një listë të përgjithshme ku thuhet "të
21 gjithë dëshmitarët përfshirë, diplomatë të dalë në pension".

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Të lutem përfundojeni.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Të mjafton të them se çështja e
24 kohës është një çështje shumë e rëndësishme dhe z. Misetic do
25 të do të komentojë shkurtimisht.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Keni një minutë. Shumë
2 shkurt, z. Misetic.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Do bëj çmos.

4 Z. Kryetar, dua t'ju përgjigjem shumë shkurtimisht
5 Prokurorisë. Kemi dëgjuar në përgjigjet e tyre ndaj
6 parashtrimin tonë që për 13 muaj ata i kanë dhënë mundësi
7 Mbrojtjes, ekipeve të Mbrojtjes që të kontaktojnë dëshmitarët.
8 Pra, pika, problemi që del këtu, "pse paskeni qëndruar të
9 heshtur gjatë të gjithë këtyre 13 muajve lidhur me një
10 protokoll të cilin ata kanë dashur që të vendosim?".

11 E kemi ngritur ne në parashtrimet tona me shkrim. Kemi
12 përmendur gjithashtu edhe sot që ne jemi akredituar, jemi
13 mbrojtës të akredituar. Askush prej nesh nuk kemi bërë
14 ndërhyrje në prova apo në dëshmi. Kështu që unë mendoj se tani
15 për herë të parë, në mënyrë të papërshtatshme ngrihen
16 pretendime të drejtpërdrejtë se Mbrojtja e z. Thaçit vendos
17 presion mbi dëshmitarët dhe thuhet se do të vazhdojë ta bëjë
18 këtë gjë. Mund të lexoni parashtrimin tonë, i nderuar [e
19 pakuptueshme] nëse kemi bërë një pretendim të tillë ne.

20 Përkundrazi ne kemi thënë të kundërtën. Unë befasohej që
21 Prokurori nuk e njihka Kodin e Sjelljes, sepse ata
22 parashtrojnë se Kodi i Sjelljes zbatohet vetëm për avokatët.
23 Ndërkohë që unë ju rikujtoj se dispozitat nenit 34 zbatohen
24 mbrojtësit, bashkëmbrojtësit dhe për të gjithë ata të cilët
25 kanë mbikëqyrje të drejtpërdrejtë, pra mbrojtës, bashkë-

1 mbrojtës.

2 Unë do të doja -- nëse do të citohet për shembull një
3 gazetë e cila kryesisht merret me skandale, do të thotë që ka
4 një person që punon për Mbrojtjen e Thaçit, nuk është ky
5 parashtrimi, po ata e bëjnë pastaj, e për ta kthyer në raundin
6 e fundit, duke arritur në përfundimin, pra duke thënë që ZPS-
7 ja sigurisht nuk e dinte që kjo ishte apo nuk ishte e vërtetë.

8 Ne ju parashtrojmë i nderuar Gjykatës që jemi të
9 tronditur nga interpretimi që u është bërë parashtrimeve tona.

10 E fundit, ajo që është më me rëndësi nga ana ime, ka të
11 bëjë me Konventën Evropiane. Ne nuk vëmë në dyshim sistemet e
12 tjera gjyqësore në vendet e tjera evropiane. Ajo që duam të
13 themi është që në një sistem si ky, ku kemi një sistem me
14 ballafaqim, ku Mbrojtjes i lejohet që të marrë pjesë në fazën
15 hetimore, ndërkohë që sistemet e tjera e lejojnë këtë gjë,
16 sidomos Kosova, në të cilin ne ndodhemi, na lejohet pra me Kod
17 të Procedurës Penale që të marrim pjesë në fazën hetimore. Nuk
18 na lejohet, sigurisht. Ne kemi të drejtën tonë për të hetuar.

19 Në bazë të Konventës Evropiane, një të drejtë që nuk
20 është dhënë në fazën hetimore të mëparshme. Në këtë pikë, unë
21 sigurisht do të thosha se cilat do të ishin rrjedhojat për
22 Konventën Evropiane, por dua që t'ju sjell në vëmendje një
23 çështje nga GJEDNJ-ja që është çështja Sander kundër
24 Mbretërisë së Bashkuar. Ku thuhet se:

25 "E drejta për të mos fajësuar veten, në veçanti,

1 presupozon që Prokuroria të tregojë kujdes për të vërtetuar
2 provat e veta, pra çështjen që ka kundër të të akuzuarit".

3 Kjo ka të bëjë edhe me prezumimin e pafajësisë, në nenin
4 6(2), të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

5 Sa i takon sigurisht çështjes nëse UÇK-ja është apo jo e
6 implikuar, kjo është një gjë të cilën ne jua lëmë juve në dorë
7 të vendosni. Por duam t'ju sjellim në vëmendje paragrafin 35
8 të aktakuzës. Sigurisht ju mund të nxirrni konkluzionet tuaja
9 lidhur me këtë.

10 Faleminderit.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Misetic.

12 Z. Emmerson.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Dua ta
14 filloj kështu.

15 Jam i sigurt që i nderuar Gjykatës është në dijeni dhe
16 unë po flas si një avokat që jam paraqitur përpara gjykatave
17 të tjera, përfshi këtu edhe GJEDNJ-në gjatë të gjithë këtyre
18 viteve. GJEDNJ-ja e shikon çdo rast më vete. Nuk flet në
19 mënyrë kategorike në përgjithësi. Mund të flasë për proces ku
20 palët ballafaqohen ose mund të flasë për një proces ku
21 gjykatësi është me palën hetuese. Nuk ka rëndësi kjo. Në
22 përgjithësi e ka mbajtur sa më të ngushtë këndvështrimin e
23 vet, për të mos qenë shumë kategorik.

24 Në këto rrethana ajo që mund të duket si fillimi i një
25 procesi të padrejtë, mund të bëhet i drejtë dhe mund të

1 menaxhohet. E thënë troç, ka një dallim shumë të madh midis
2 ndërhyrjes së tepruar dhe të drejtat e mbrojtjes dhe një gjë
3 që është proporcionale.

4 Ne jemi tejet të shqetësuar sa i takon qëndrueshmërisë së
5 këtij procesi. Nëse miratohet ky protokoll ashtu siç
6 propozohet do të ishte e pamundur që çështja gjyqësore të
7 ishte e gatshme për gjykim brenda afateve praktike.

8 Sa më shumë të zgjasë procedura paraprake, aq më shumë do
9 të qëndrojnë në paraburgim. Se duhet ta supozojmë që do të
10 qëndrojnë në paraburgim të akuzuarit. Ky është një proces i
11 cili nëse zbatohet në mënyrë të tepruar dhe për të gjithë
12 dëshmitarët siç e kërkon Prokuroria, kjo do ta zgjaste
13 gjithnjë e më shumë mbajtjen në paraburgim të personave që
14 prezumohen që janë të pafajshëm. Kjo është pikënisja e
15 gjykimit nëse është një reagim proporcional apo jo.

16 Tani që u dëgjuan të gjitha parashtrimet e të gjitha
17 palëve, unë desha t'ju bëj një propozim. Nëse flasim për një
18 dëshmitar i cili është mbrojtur me urdhrin tuaj dhe vazhdon të
19 jetë efektive masa mbrojtëse, pra nuk ka -- jemi afruar 30
20 ditë gjykimi apo dhënies së dëshmisë. Mund të duket kategorike
21 por kështu më duket mua. Një individ i tillë duhet të ishte
22 objekt i protokollit, pra mund të ishte objekt i protokollit,
23 i kushteve të protokollit, pa shkelur të drejtat e të
24 akuzuarit sepse janë kufizuar tashmë të drejtat e të akuzuarve
25 deri diku.

1 Dhe duhet të supozojmë, nuk e di nëse është e vërtetë apo
2 jo dhe Prokuroria mund ta konfirmojë se këta dëshmitarë kur u
3 është kërkuar, kur janë pyetur nëse duan apo jo këtë mbrojtje,
4 këta dëshmitarë kanë kërkuar vetë mbrojtjen. Është një kërkesë
5 të cilën Prokuroria e ka bërë në marrëveshje me dëshmitarin.
6 Se përndryshe, do të kishim një problem të vërtetë. Por ta
7 supozojmë se është ky rasti.

8 Atëherë ky dëshmitar do të ishte shumë e vështirë që
9 intervistohet nga ne pa shkelur masën mbrojtëse që është
10 miratuar tashmë. Sepse do të duhet që të bëhen pyetje të
11 caktuar, të bëhen organizime të caktuara të tjera.

12 Mua më duket se Mbrojtja mund të zbatohet në këto raste pa
13 ndonjë ndërhyrje të ndjeshme.

14 Kategoria e dytë janë dëshmitarët me cilësinë e viktimës
15 të cilët nuk janë objekt i masave mbrojtëse. Pra personat për
16 të cilët nuk është kërkuar mbrojtja e identitetit. Mua më
17 duket se me këtë kategori ne mund të sillemi duke i dhënë
18 njoftim z. Laws, sepse ai përfaqëson të gjithë ata dhe duke
19 garantuar që intervistat të zhvillohen nga avokati i Mbrojtjes
20 në bazë të dispozitave të Kodit të Sjelljes dhe jo nga
21 hetuesit. Sepse dhe sigurisht mund të jetë i pranishëm edhe z.
22 Laws, nëse ai mendoj që ajo që po diskutohet me individin --
23 ai mund të ishte aty i pranishëm për njerëz të tillë, për të
24 thënë mendimin e tij.

25 Në dallim nga ajo që thotë z. Laws që duhet që të bëhen

1 150 kërkesa, sepse nuk janë të gjithë këta personat që kanë
2 kërkuar masa mbrojtëse. Përkundrazi do të ishin vetëm në
3 kushte përjashtimore ku do të zbatohet një gjë e tillë duke
4 qenë se do të ishte e vetmja gjë që do të ndryshojë pas
5 momenti kur kërkohet masa mbrojtëse në fjalë.

6 Sa i takon dëshmitarëve të tjerë, nuk ka asnjë justifikim
7 për të zbatuar për ta këtë protokoll. Nëse dëshmitari është
8 kundër vendosjes së kontaktit ai mund të kundërshtojë në këtë
9 pikë, nëse justifikohet, pasi të diskutohet dhe me
10 dëshmitarin. Prokuroria mund të bëjë një kërkesë të
11 përshtatshme për këtë çështje në mënyrë që dëshmitari në fjalë
12 të trajtohet në bazë të protokollit.

13 Prandaj dhe qasja që duhet ndjekur është ajo që propozova
14 unë, në mënyrë që edhe të mos cenohen të drejtat bazë edhe të
15 mos jetë shumë e tepruar qasja dhe kjo pastaj do të mbronte
16 edhe atë grup të ngushtë dëshmitarësh të cilët do të përbënin
17 -- do të ishin me interes për t'u mbrojtur në këtë rast. Kjo
18 do t'i jepte mundësi z. Laws për shembull që të bënte kërkesë,
19 apo edhe Prokurorisë që të bënte kërkesë pasi të jetë njoftuar
20 se do të kontaktohet dëshmitari në fjalë.

21 Mund të mbahet e qartë se mbase mund të ketë disa
22 dëshmitarë të z. Laws që mund të mos kenë asnjë kundërshtim që
23 të intervistohen për shembull nga ekipet e Mbrojtjes. Mbase
24 duan që të intervistohen. Unë mendoj se kështu do të veprohet
25 në mënyrë proporcionale.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emerson, e keni të
2 fikur mikrofonin.

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk e di se
4 si ndodhi kjo.

5 Parashtrimi i dytë është i shkurtër. Sugjerimi i
6 atmosferës së frikësimit në Kosovë.

7 Nuk do kundërshtoj se ka pasur raste të shumta në të
8 cilat në Kosovë dëshmitarët ose janë frikësuar ose nuk kanë
9 dhënë dëshmi, nuk kanë pranuar që të japin dëshmi në gjykatë.
10 Të gjitha këto janë raste që kanë ndodhur menjëherë mbas
11 luftës, në vitet e para, pra pas luftës. Do të ishte absurde
12 që kjo ndodh edhe sot në Kosovë.

13 Kosovë tashmë është zhvilluar. Në pushtet ka një parti
14 tjetër politike. Situata nuk është ajo që ka qenë në vitet e
15 para mbas luftës, pra nuk është ajo -- nuk përputhet ajo që
16 thotë Prokuroria me situatën në terren.

17 Ka pasur shumë raste, sidomos në gjykimin Gucati dhe
18 Haradinaj ku ka pasur dëshmitarë -- më falni ka pasur
19 dëshmitarë shumë në rastin e gjykimit të Haradinajt ku citohen
20 nga Prokuroria, të cilët kanë dhënë dëshmi të ndryshme nga ato
21 që kishin dhënë përpara intervistave të tyre.

22 Kjo faktikisht ka lidhje edhe me kërkesën e tyre për të
23 qenë refugjatë në vende të caktuara, të cilën mund të thuhet
24 pra, ata për shembull mund të kenë gënjyer për të marrë
25 statusin e refugjatit. Ka pasur edhe një sërë dëshmitarësh të

1 cilët nuk kanë pasur dëshirë që t'i japin dëshmi dhe është
2 marrë vesh më pas se kanë qenë njerëz të cilët janë shtyrë që
3 të thonë gjëra nga shërbimet e inteligjencës serbe.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju lutem mund ta mbyllni
5 sepse edhe dhjetë minuta na kanë mbetur.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Atëherë,
7 thjesht po them që situata është shumë herë më e ndryshme, me
8 shumë më tepër ngjyra sesa ajo çfarë ju prezantohet nga
9 Prokuroria. Dhe dëshmitarët e tjerë që unë iu referova në
10 çështjen Haradinaj, u kërkuan që të vinin dhe të jepnin dëshmi
11 sipas porosive të caktuara dhe të cilët u quajtën, domethënë u
12 gjykuan dhe u shpallën fajtorë.

13 Pra, ky është pozicioni sa i takon frikësimit të
14 dëshmitarëve.

15 Nuk dua që të flas sa i takon pjesës së kritikës që u
16 përmend nga Mbrojtja e z. Thaçi. Pra, kjo është një çështje e
17 cila në fakt nuk është çështje, nuk është vetëm kundër katër
18 të akuzuarve, por është edhe për të gjithë UÇK-në.

19 Pra, siç është thënë edhe në dosjen paraprake të ZPS-së,
20 sa i takon akuzës së klientit tim, akuza kundër klientit tim
21 është drejtuar vetëm për faktin që ai ka qenë pjesë drejtuese
22 e UÇK-së. Domethënë, me fjalë të tjera. Për shkak të rolit që
23 ai ka pasur, prezumimi i Prokurorisë është që ai duhet të jetë
24 përgjegjës. Për çdo person i cili ka pasur të veshur uniformën
25 e UÇK-së, në çdo kohë në Kosovë, domethënë që nga fillimi i

1 periudhës së aktpadisë deri në fund fare.

2 Dhe me fjalë të tjera, domethënë ideja është që e gjithë
3 UÇK-ja po atakohet si ndërmarrje kriminale e përbashkët dhe jo
4 vetëm të akuzuarit.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Një moment Prokuror.

6 Z. Emmerson, shumë shkurtimisht se mbaroi koha.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Prokuroria
8 duket sikur po bën hapa mbrapsht sa i takon rrezikut të
9 dëshmitarëve për kryerjen e një krimi. Domethënë duket sikur
10 ka ndryshuar pozicionin e vet lidhur me këtë.

11 Dhe gjithsesi, ky parashtrim është joprofesional, është i
12 pabesueshëm dhe cenon besueshmërinë e Prokurorisë. Kështu që
13 do t'i kërkoja Prokurorisë që të tërhiqte këto pretendime
14 skandaloze dhe shpifëse dhe dua që ai të kërkojë ndjesë për
15 akuzë të tillë dhe dua që të merret masë kundër sjelljes së
16 tij.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju lutem shumë shkurtimisht
18 z. Prokuror dhe vetëm lidhur me atë çfarë u tha deri tani. Pra
19 kemi vetëm nëntë minuta në dispozicion dhe duhet ta ndajmë
20 kohën ndërmjet ekipeve.

21 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Mbrojtja sapo keqinterpretoi
22 çështjen Haradinaj dhe aktakuzën dhe dosjen paraprake të ZPS-
23 së. Kjo nuk është serioze sepse të gjithë mund të lexojnë
24 gjykimet, mund të lexojnë paraprake të ZPS-së dhe nuk ka
25 absolutisht asnjë lloj arsyeje se pse të ndryshohen historitë

1 dhe të përdoren, të luhet me fjalë.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Tully, fjala për ju.

3 Z. TULLY: [Përkthim] Shumë shkurtimisht.

4 Ne nuk dëgjuam ndonjë përgjigje nga Prokuroria që i
5 rrëzonte apo ishte kundër parashtrimeve tona.

6 Ne mendojmë që informacioni që përmbahet në përgjigje, ka
7 informacion që ka të bëjë me parashtrimet e mëparshme.

8 Domethënë është e rëndësishme që ZPS-ja të mund të
9 identifikojë dëshmitarët rast pas rasti, të tregohen
10 specifikat e secilit prej tyre dhe në qoftë se vendoset që ata
11 janë në një pozitë të tillë të disfavorshme, duhet dhe mund të
12 kërkohen masa mbrojtëse për ta.

13 Faleminderit.

14 Z. BAIESU: [Përkthim] Me lejen tuaj, z. Ellis do të
15 përgjigjet Gjykatës.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Do të mundohem
17 që të jem shkurt, megjithëse e shikoj që video e ndezur. Kam
18 dy pika për të ngritur. Pika e parë është kjo. Ne kërkojmë
19 justifikim nga ZPS-ja për vendosjen e një protokolli për
20 dëshmitarët ndërkombëtarë. Përgjigja që u dha nga ZPS-ja ishte
21 që të shikoj parashtrimi 5, shtoja 1, paragrafi 5, 6 dhe 7.

22 Unë e bëra këtë gjë. Para 6 dhe 7 janë paragrafë të
23 përgjithshme të natyrës që kemi dëgjuar sot në gjyq. Paragrafi
24 7 lidhet me një dëshmitar konkret ndërkombëtar që duket që
25 është një person i cili është në nivel jo të lartë. Pra nuk

1 është një person i lartë në hierarkinë ushtarake apo ambasador
2 apo persona të tjerë ndërkombëtarë që kanë qenë pjesë e
3 listave të dëshmitarëve.

4 Pra personi në fjalë nuk është një burim i mirë shpjegimi
5 dhe vërtetimi për të thënë se pse të gjithë dëshmitarët
6 ndërkombëtarë duhet po ashtu të gëzojnë masa mbrojtëse.

7 Duke trajtuar parashtrimin e z. Laws, sigurisht që unë
8 nuk kërkoj që z. Laws të bëjë 157 kërkesa të ndryshme. Kjo nuk
9 është mënyra se si kanë funksionuar masat mbrojtëse për këtë
10 çështje. Kemi ende mbi 100 dëshmitarë që janë objekt i
11 nxjerrjes së vonuar ose shtyrjes së nxjerrjes. Dhe nuk është
12 se kemi kërkuar kërkesa për secilin prej tyre.

13 Këtu po flasim për masat mbrojtëse. Kështu që Prokuroria
14 dhe avokati i mbrojtjes mund të kenë, për shembull një kohë të
15 caktuar, një afat të caktuar të bëjnë një listë të plotë, në
16 kërkesën e tyre të mund të bëjnë një kërkesë gjithëpërfshirëse
17 për dëshmitarët. Nuk është e thënë që ata të bëjnë kërkesë për
18 secilin prej këtyre dëshmitarëve. Kështu që unë jam pro
19 rekomandimit që u bë nga z. Emmerson lidhur me kategorizimin e
20 dëshmitarëve.

21 Megjithatë nuk mendoj që duhet të bëhet një protokoll për
22 të gjithë dëshmitarët se pse kjo nuk është e justifikuar për
23 secilin prej tyre.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Ellis.

25 Kemi mbërritur në fundin e procesit për sot. Ju

1 falënderoj të gjithë pjesëmarrësve. Dhe dua t'ju kujtoj që
2 Konferenca e radhës për Ecurinë e Çështjes është planifikuar
3 për datën 24 mars, në orën 14.30.

4 Dua të falënderoj përkthyesit dhe stafin audioviziv për
5 ndihëm e tyre.

6 Seanca mbyllet këtu.

7 --- Seanca përfundon në orën 17.55

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25